



Ministria e Drejtësisë
Ministarstvo Pravde
Ministry of Justice

Zyra e Koodinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje
Kancelarija Nacionalnog Kordinatora protiv nasilja u Porodici
National Coordinator's Office against Domestic Violence

Aktivitetet kundër Dhunës në Familje

Raporti Vjetor i Progresit

2012

Maj 2013

Prishtinë, Kosovë

Fjala hyrëse

Njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë qenjëve njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.

Mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut fyen ndërgjegjëjen njerëzore, prandaj aspirata më e lartë e çdo njeriu është krijimi i një bote në të cilën njerëzit gëzojnë lirinë e fjalës, besimit, lirinë nga frika dhe skamja - Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948, e Asamblesë së Përgjithshme të KB.

Dhuna, e sidomos ajo në familje ishte diçka që mbahej mbrenda mureve të shtëpisë dhe përbënte një çështje private , por me zhvillimin e shoqërisë kjo çështje mori dimensione të ndryshme, duke krijuar një mjedis ligjor dhe mekanizma që do të garantojnë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe ndëshkimin e atyre që ushtrojnë këtë dhunë.

Dhuna në familje, kudo që ndodhë ajo, është shkelje e të drejtave të njeriut, e që më së shumti prekë gratë dhe vajzat, duke mos përjashtuar të gjitha shtresat e shoqërisë, pa dallim.

Institucionet shtetërore kanë obligim ndaj qytetarëve që të krijojnë një mjedis në të cilin jetohet pa dhunë.

Rastet e dhunës në familje janë reflektim i dobësisë institucionale, andaj angazhimi dhe pjesëmarrja politike e Qeverisë së Kosovës garanton suksesin e implimentimit të këtij programi.

Kordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje së bashku me Grupin Koordinues Ndërministror, ekspertët, vëzhguesit dhe OJQ-të, do të mbeten të përkushtuar në realizimin e suksesshëm të këtij programi.

Andaj, ne zotohemi se do të ndërtojmë një shoqëri ku respektohen të drejtat dhe liritë e çdo individit, një shoqëri me vlera, pa dhunë dhe diskriminim.

Zëvendës Ministër i Drejtësisë,

Daut Xhemajli

Përmbajtja:

I. PËRMBAJTJA:	3
II. LISTA E SHKURTESAVE:	4
III. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
IV. HISTORIKU	7
A. DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË	7
B. STRUKTURA E DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË	10
C. PROGRAMI I KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE PLANI I VEPRIMIT 2011-2014	12
V. PROGRESI	14
A. PËRGJITHSHM	14
B. SHTYLLA 1. PARANDALIMI	15
1. Progresi i përgjithshëm në shtyllën e Parandalimit.....	15
2. Aktivitetet kryesore.....	15
3. Kampanja e 8 Marsit dhe 16 Ditë e Aktivizmit.....	30
4. Përmbledhje e aktiviteteve	32
C. SHTYLLA 2. MBROJTJA DHE SIGURIA	33
1. Progresi i përgjithshëm në shtyllën e Mbrojtje.....	34
2. Aktivitetet kryesore.....	34
3. Përmbledhje e aktiviteteve.....	47
D. SHTYLLA 3. PERKRAHJA, TRAJTIMI DHE RI-INTRIGIMI	48
1. Progresi i përgjithshëm në shtyllën e Rehabilitimit.....	48
2. Aktivitetet kryesore.....	49
3. Përmbledhje e aktiviteteve.....	50
VI. BASHKPUNIMI DHE SINERGJIA	51
VII. SFIDAT	52
VIII. KONKLuzionet	52
IX. REKOMANDIMET DHE HAPAT E MËTEJM	53
X. SHTOJCA	55
A. STATISTIKA E POLICISË.....	55
B. INSTITUCIONET QË KANË RAPORTUAR.....	56

II. Lista e Shkurtesave:

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KSHK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KSK	Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës
KN	Kordinatori Nacional
KKP	Kordinatori Komunal i Programit
UNDP	(PKBZH) Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNFPA	Agjencia e KB për Fondin për Popullatën
UM	Urdhëri Mbrojtës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave

MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri e Bashkëpunim Evropian
PK	Policia e Kosovës
PKKDHf-PV	Program i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plan i Veprimit
PSH	Prokurori i Shtetit
PV KTQNJ	Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
QPS	Qendra për Punë Sociale
RrGGK	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
DhBGj	Dhuna në Baza Gjinore
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
WSSI	(IMSG) Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

III. Përmbledhja Ekzekutive

Dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore është prezente në shoqërinë tone, prandaj kemi sfida dhe obligime institucionale shtetore, që të ndërtojmë një shoqëri ku gratë dhe vajzat mund të kenë dhe të i realizojnë të gjitha të drejtat e tyre sociale, ekonomike dhe kulturore.

Qeveria e Kosovës duke zbatuar përgjegjësitë ligjore dhe duke reflektuar ndaj këtij fenomeni, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, më 25.08.2011 miratoi Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2011-2014, bartëse e të cilit ishte ABGJ dhe i cili u hartua në bashkëpunim me institucionet e caktuara përgjegjëse dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Me 11.07.2012 me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 04/83 u emërua Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe u caktuan përgjegjësitë e tij për udhëheqjen e procesit të zbatimit të këtij programi, njëkohësisht u caktua edhe përbërja e Grupit Koordinues Ndër-Ministror dhe përfaqësimi i ekspertëve në Grup, si dhe u miratuan termat e referencës për KNKDHF dhe Grupin Koordinues Ndër-Ministror.

Lufta kundër dhunës në familje tashmë ka marrë të gjitha dimensionet institucionale dhe politike, duke përfshirë dhe aktivizuar të gjitha segmentet e shoqërisë kosovare.

Programi shërben si udhëzues nacional për ngritjen e nivelit të shërbimeve ekzistuese, duke u mbështetur në tri shtylla kryesore:

 **Parandalimin,**

 **Mbrojtjen dhe sigurinë,**

 **Përkrahjen, trajtimin dhe reintegrimin.**

Në raport janë të përfshira përmbledhjet e aktiviteteve që janë zbatuara gjatë vitit 2012, si pjesë e Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014.

IV. Historiku

A.Dhuna në Familje në Kosovë

Dhuna në familje është akt që shkel të drejtat e njeriut. Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë, këto të drejta i takojnë çdonjërit dhe janë të patjetërsueshme. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore të cilat duhet të i gëzojë çdo qenie njerëzore.

Në Kosovë dhuna në familje përkufizohet si çdo veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezultojnë në keqtrajtim, e që kryhet nga një person i cili është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën, duke përfshirë këtu keqtrajtimin fizik (dhunë fizike, dhembje fizike, frikë), keqtrajtim psikik (presioni psikik, vuajtje psikike, shkaktim i ndjenjës së frikës, cenim i dinjitetit, ofendimi, përlulja), keqtrajtimi seksual (mardhënja dhe keqtrajtimi seksual), keqtrajtimi ekonomik (dëmtimi, shaktërrimi i pasurisë, frikësimi për pozitën ekonomike të viktimës).

Sipas Ligjit ,Institucionet e shtetit kanë qëllim dhe obligim të parandalojnë dhunën në familje, të mbrojnë dhe sigurojnë viktimat, të ndjekë kryerësit si dhe të ofrojnë përkrahje, trajtim dhe reintegrim për viktimat e dhunës në familje.

Në Kosovë, ende nuk ka një sistem të të dhënave statistikore periodike të unifikuara mbi dhunën në familje, prandaj në mungesë të tyre janë përdorur rezultatet nga anketat, studimet dhe hulumtimet e kryera të cilat kanë shërbyer si bazë për formulimin e politikave dhe programeve kundër dhunës në familje, nga institucionet qendrore dhe lokale. Megjithatë këto studime e hulumtime na përfaqësojnë me situatën reale të dhunës në familje në Kosovë, pavarësisht përceptimeve të ndryshme për këtë fenomen në shoqërinë tonë.¹

Nga të dhënat e prezentuara në këtë raport kuptojmë se dhuna në familje në Kosovë është një fenomen me përmasa relativisht të larta, por raportet tregojnë se ajo edhe po trajtohet nga Institucionet kompetente në Kosovë.

¹PKKDHF dhe PV


Statistikat bazike krahasimore të rasteve të trajtuara të dhunës në familje për vitet 2011 / 2012 nga Policia e Kosovës

Viti	2011	2012
<i>Nr. i rasteve të dhunës në familje</i>	1046	1021
<i>Viktima të strehuara</i>	108	302
<i>Viktima të identifikuar, femra</i>	813	822
<i>Viktima të identifikuar, meshkuj</i>	239	219
<i>Arrestime</i>	228	260
<i>Kallëzime penale</i>	824	902

Enti i Statistikave të Kosovës ofron shënimet si në vijim:

Dhuna familjare sipas gjinisë dhe viteve, 2010/2011

Viti	2010	2011
Gratë	764	813
Burrat	190	239



Burimi: PK, Drejtoria për Krime të Rënda, 2010 dhe 2011

B. Struktura Institucionale Kundër Dhunës në Familje në Kosovë

Institucionet e Kosovës në përpjekje për të luftuar dhunën në familje përmes mekanizmave institucionale, janë organizuar dhe kanë themeluar strukturën Institucionale Kundër Dhunës në Familje në krye të së cilës kanë emëruar Koordinatorin Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe Grupin Koordinues Ndër-Ministror, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrive dhe Institucioneve tjera relevante të Kosovës. Ky grup është zgjeruar dhe plotësuar edhe me anëtar të tjerë, si vëzhgues nga shoqëria civile dhe partner ndërkombëtarë, të cilët mbështesin parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje në Kosovë.

Bashkarisht ky grup është duke u përpjekur për të koordinuar dhe trajtuar dhunën në familje nga disa aspekte, duke filluar nga **parandalimi** (përmes ndërgjegjësimit aktivitetëve dhe hetimeve proaktive), duke vazhduar për **mbrojtjen**, **rehabilitimin dhe reintegrimin** e viktimave.

Kordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje është zëvendësministri i Drejtësisë, z. Daut Xhemajli, i cili është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktivitetëve dhe veprimeve të parapara në Programin Kundër Dhunës në Familje.²

Kordinatori Nacional, mbështetet nga Sekretariati kundër dhunës në familje, që është përgjegjës për të siguruar mbështetje administrative dhe logjistike për Kordinatorin Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe shërben si pikë referimi për të siguruar që Programi aktual është duke u zbatuar nga të gjitha palët përgjegjëse nëpërmjet koordinimit, raportimit dhe monitorimit të aktivitetëve të tyre.

Grupi Ndër-Ministror është i përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse, mandat i të cilëve është që të koordinojnë zbatimin e politikave, monitorimin, dhe të raportojnë periodikisht mbi progresin e shënuar, në Zyrën e Kordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje, përkatësisht në Sekretariatin Kundër Dhunës në Familje.


Përfaqësues nga ministritë përkatëse dhe institucionet tjera marrin pjesë në Grupin Ndër-Ministror, ndërsa OJQ-të lokale dhe partnerët ndërkombëtarë janë të përfaqësuar në Grupin Koordinues Ndër-Ministror në cilësinë e ekspertëve, duke patur parasysh rolin e tyre në fushën e parandalimit dhe të asistencës për viktimat. Ky Grup është i përkushtuar për të luftuar dhunën në familje, në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë duke u bazuar në PKKDFH dhe PV 2011-2014, si udhëzues për implementimin e kësaj strategjie.

Organogrami i Grupit Koordinues Ndër-Ministror është paraqitur më poshtë:

²Raporti i ABGJ

Struktura Organizative e Koordinimit, Monitorimit dhe Zbatimit të mekanizmave kundër Dhunës në Familje në Kosovë

Niveli Strategjik



Niveli Opercional

Parandalimi

- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Punëve të Brendshme / PK
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Financave
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- ZKM, ABGJ
- OJQ-të, Lokale dhe Ndërkombetare

Mbrojtja dhe siguria

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Drejtësisë
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës/MV
- Policia e Kosovës
- Organizatat Ndërkombëtare
- OJQ-të, Lokale dhe Ndërkombëtare

Perkrahja dhe Trajtimi dhe Riintegrimi

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Drejtësisë
- Organizatat Ndërkombëtare
- OJQ-të, Lokale dhe Ndërkombëtare
- Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës
- OJQ-te Lokale dhe Ndërkombëtare

C. Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014

Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, mundëson koordinimin dhe bashkërendimin e strategjive dhe përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse të ministrive të ndryshme dhe organizatave jo-qeveritare në një qëllim të vetëm për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje³.

Në Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje ABGJ-ja ,përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, me rekomandimet e ekspertëve të angazhuar kanë identifikuar dhe dizajnuar tri shtylla mbi të cilat është bazuar lufta kundër dhunës në familje.

Duke patur qëllim përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, në Program janë adresuar edhe çështje të rëndësishme, për të patur sukses në zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërisë sonë si; mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që merren me dhunën në familje, niveli i ulët i kapaciteteve për adresimin e çështjeve të dhunës në familje ndërmjet aktereve kryesorë, mangësitë në sistemin e referimit dhe mungesën e infrastrukturës për t'i përkrahur viktimat.

Parandalimi: Shtylla e parë e Programit Kundër Dhunës në Familje, ku synohet të identifikohen mënyra për edukimin dhe vetëdijësimin e shoqërisë /qytetarëve të Kosovës për dhunën në familje dhe pasojat e saj, si dhe të rrisë kapacitetet e komunitetit në mënyrë që t'i përgjigjen fenomenit dhunë. Gjithashtu, programi synon të identifikojë mënyra dhe mjete që viktimat e dhunës në familje të marrin informacionin e nevojshëm për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Mbrojtja dhe Siguria: Shtylla e dytë e Programit Kundër Dhunës në Familje, e cila përmbanë aktivitete të cilat do të ndikojnë në sigurimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, nëpërmjet shërbimeve ligjore dhe sociale adekuate, siç janë mbrojtja ligjore dhe ajo fizike.

Përkrahja dhe Trajtimi dhe Re-integrimi: Shtylla e tretë e Programit, në kuadër të së cilës do të identifikohen dhe ofrohen forma veprimi me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje, trajtimin profesional të kryerësve dhe abuzuesëve të dhunës në familje deri në integrimin e plotë të tyre në jetën normale.

Re-integrimi i viktimave të dhunës në familje është një proces i gjatë që kërkon një qasje multidiciplinore dhe njëkohësisht një kyçje të të gjithë akterëve që punojnë në mbrojtjen dhe ofrimin shërbimeve për viktimat e dhunës deri në një fuqizim të plotë të viktimës.

³PKKDHFDHF dhe PV, faqe 23

Ndërsa, objektivat (strategjike dhe specifike) që pritët të realizohen janë:⁴

- Të krijojmë mekanizma efikase dhe gjithëpërfshirëse për parandalimin e dhunës në familje: Të hartohen politika në nivel qendror dhe lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje; Të sensibilizohet shoqëria mbi dhunën në familje; Të krijohen mekanizma për edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjëve mbi dhunën në familje; Të rritet masa e raportimit të dhunës në familje.
- Të ketë mekanizma efikase të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje: Të sigurojmë shërbime efikase për mbrojtjen fizike të viktimave të dhunës në familje në të gjithë territorin e Kosovës; Të ngremë kapacitetet e akterëve (policisë, prokurorisë, gjykatave dhe Qendrave për Punë Sociale) për trajtimin e dhunës në familje; Të sigurojmë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje.
- Të sigurojmë shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryesve të dhunës në familje: Të ndërtojmë dhe fuqizojmë kapacitetet e punonjësve të shëndetësisë, të shërbimeve sociale dhe arsimore për ofrimin e shërbimeve viktimave të dhunës në familje; Të ngritën politika të mbështetjes ekonomike të viktimave dhe ushtrueseve të dhunës; Të ndërtojmë dhe fuqizojmë shërbime sociale (shëndetësore, arsimore, sociale, ekonomike, juridike) për viktimat dhe kryesit e dhunës në familje.

Programi përfshinë një mori aktivitete që duhet të zbatohen prej vitit 2011 deri në vitin 2014 në mënyrë që të arrihen objektivat. Gjithashtu, parashihet themelimi i një mekanizmi për monitorim dhe koordinim me qëllim të sigurimit të suksesit të implimentimit të programit.

⁴PKKDDHF dhe PV, faqe 49

V. Progresi

A. Përgjithshme

PKDHF dhe PV 2011-2014 u miratua me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 08/34 të datës 25.08.2011, ndërsa ka filluar të implementohet menjëherë pas vendimit për emërimin e Kordinatorit Nacional.

Gjatë vitit 2012, janë zhvilluar shumë aktivitete nga Institucione të caktuara të cilat kanë qenë pjesë e Programit dhe e Planit të Veprimit për këtë vit dhe mund të konstatojmë se ka qenë një nismë e mbarë e suksesshme dhe progresive, për realizimin e këtij Programi në shumë fusha.

Më 17.09.2012, Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje, pas delegimit të përfaqësuesve të institucioneve të caktuara, ftoi takimin e parë me ç'rast u bë konstituimi i Grupit Koordinues Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje. Gjatë muajit shtator u mbajt edhe një punëtori njëditore e Grupit Koordinues Ndër-Ministror së bashku me ekspertët dhe grupin punues për hartimin e Procedurave Standarde Operative të Veprimit.

Me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare kundër dhunës në baza gjinore dhe fillimit të fushatës ``16 ditët e aktivizimit`` Kordinatori Nacional me 25.11.2012 ftoi konferencën me temën: `` Arritjet e implimentimit të Planit Nacional dhe Strategjisë Kundër Dhunës në Familje për vitin 2012``

Fushata kombëtare ``16 ditët e aktivizimit`` u përmbyll me 10.12.2012, ditë për shënimin e të drejtave të njeriut , me ç'rast nga Koordinatori Nacional u mbajtë një konferencë me temën `` Trajtimi i rasteve të dhunës në familje për vitin 2012``.

Me qëllim që të kuptohen më mirë të arriturat e programit KDHF dhe PV raporti është ndarë në tri shtylla:

- *Parandalimin,*
- *Mbrojtjen dhe sigurinë,*
- *Përkrahjen, trajtimin dhe re-integrimin.*

Për secilen shtyllë do të raportohet për progresin e përgjithshëm, aktivitetet kryesore dhe përmbledhjen e veprimeve.

Parandalimi

1. Progresi i përgjithshëm në shtyllën e parandalimit

Si shtyllë e parë e Programit nënkupton se institucionet e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët e mbrendshëm dhe ata ndërkombëtar do të gjejnë mënyrat më të mira për edukimin dhe vetëdijësimin e shoqërisë kosovare për Dhunën në Familje, pasojat e saja, gjithashtu të ngriten kapacitetet e komunitetit në mënyrë që t'i përgjigjen fenomenit dhunë. Ndërsa viktimat e dhunës në familje të kenë informacione të nevojshme për përmirësimin e sigurisë dhe mirëqenies së tyre.

Kjo shtyllë obligon dhe angazhon të gjitha institucionet dhe OJQ-të që të unifikohen, ndajnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore.

Progresi në këtë shtyllë ka qenë evident, janë ndërmarrë shumë aktivitete dhe janë shënuar suksese evidente, ndërsa akterët kryesor që kanë luajtur role të veçantë në implimentimin e kësaj shtylle janë: MKRS, MASHT, PZHKB (UNDP), IMSG (WSSI Plus) ABGJ, OSBE, etj.

Aktivitetet kanë qenë të orientuara në informimin, senzibilizimin, edukimin dhe vetëdijësimin e shoqërisë mbi të drejtat e tyre dhe mbi dhunën si dukuri prezente në vendin tonë.

2. Aktivitetet kryesore

Një mori aktivitete janë zbatuar në kuadër të shtyllës së parë dhe janë raportuar nga akterët e ndryshëm, që janë pjesë e PKDHF dhe PV.

Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje / Ministria e Drejtësisë

Koordinatori Nacional, ka zhvilluar takimin e parë me rastin e konstituimit të Grupi Koordinues Ndër-Ministror, ku janë shkëmbyer përvoja dhe informacione në mes të gjithë akterëve, në përpjekje të koordinimit të aktiviteteve mes tyre.

Gjithashtu nga K. Nacional, është mbajtur punëtorja njëditore për Hartimin e Procedurave Standarde Operative të Veprimit për trajtimin e viktimave të dhunës në familjen dhe janë mbajtur edhe dy konferenca : ``Arritjet e Implimentimit të Planit Nacional dhe Strategjisë Kundër Dhunës në Familje për vitin 2012``ku edhe filloi fushata ``16 Ditët e Aktivizmit`` dhe shënimi i ditës ndërkombëtare kundër dhunës në baza gjinore. Ndërsa, koferenca tjetër ishte me rastin e përmbylljes së fushatës me temën ``Trajtimi i rasteve të dhunës në familje për vitin 2012``.

Agjencia për Barazi Gjinore

ABGJ-ja ka qenë bartëse e propozimit të vendimit për Qeverinë e Kosovës për emërimin e Koordinatorit Nacional dhe Grupit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe aktivitetet e saj i ka zhvilluar bazuar në Programin e Kosovës dhe Planin të Veprimit, sidomos në kuadër të shtyllës së parë të Parandalimit.

Në kuadër të shtyllës së parandalimit, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për pasojat e dhunës në familje dhe përkushtimin e gjithë shoqërisë për eliminimin e kësaj dukurie, ABGJ-ja ka vazhduar me udhëheqjen e grupit punues për hartimin e Procedurave Standarde Operative për trajtimin e viktimave të dhunës në familje. Ka realizuar trajnimin e punëtorëve social të Qendrave për Punë Sociale në bashkëpunim me MPMS-në dhe OSCE mbi Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

ABGJ-ja në bashkëpunim me WSSI/UNDP-në dhe OSCE ka organizuar punëtori një ditore me redaktorët e mediave të shkruara dhe elektronike që raportojnë Dhunën në Baza Gjinore. Me rastin e 16 ditëve të aktivizmit - për eliminimin e dhunës ndaj grave me moton **``Komuniko me fjalë, jo me dhunë``** ka organizuar disa aktivitete: shpërndarjen e completeve të legjislacionit në fuqi që ofrojnë mbrojtje nga dhuna në familje dhe garanton barazi gjinore, në 5 libraritë e kryeqytetit. Po ashtu, në bashkëpunim me WSSI/UNDP-në janë vendosur reklama në tërë vendin me moton e lartëcekur. Ka realizuar një videoklip si reklamë televizive, që adreson dhunën në familje përmes angazhimit të figurave publike që flasin për domosdoshmërinë e luftimit të kësaj dukurie negative.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Në kuadër të përgjegjësiave ligjore për zhvillimin e politikave dhe ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare për viktimat e dhunës në familje si dhe monitorimin e inspektimin e kualitetit të shërbimeve sociale duke siguruar zbatimin e politikave, legjislacionit dhe minimumin e standardeve për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ka realizuar kontrata dhe marrëveshtje për blerjen e shërbimeve përmes tenderimit për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me 6 (gjashtë) strehimoret e Kosovës duke i mbështetur ato me 50% të shpenzimeve me shumën mujore prej 2000,00 Euro për secilën strehimore.

Qendrat për Punë Sociale gjatë vitit 2012 kanë raportuar për 300 raste që janë trajtuar viktimat të dhunës në familje nga të cilat 220 janë gra, 15 viktimat të mitura dhe 65 fëmijë të prekur indirekt nga dhuna në familje. Në bashkëpunim me OSCE dhe ABGJ-në, ka mbajtur trajnim për ofruesit e shërbimeve sociale në QPS, OJQ dhe zyrtar për barazi gjinore për adresimin e dhunës në familje, të drejtat e njeriut dhe kornizën ligjore të Kosovës.

Ka shtyrë realizimin e Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psiko-social të kryerësve të dhunës në familje nga Kryeministri.

Përveq angazhimit në rolin primar të kësaj ministrie për përkrahjen, trajtimin dhe re-integrimin, ajo gjatë vitit është angazhuar edhe në aktivitetet e parandalimit dhe senzibilizimit të opinionit kundër dhunës në familje, duke marrë pjesë në takimet e organizuara nga Koordinatori Nacional, duke marrë pjesë në programin e mëngjesit në RTV 21, me temën “trajtimi i rasteve të dhunës në familje” dhe në emisionin “Në kërkim” të RTK-së. Përfaqësuesit e saj, gjithashtu kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga të gjithë akterët, ku qëllimi ishte të kontribohet në vetëdijësimin dhe senzibilizimin e luftës kundër dhunës në familje.

Ministria e Punëve të Brendshme / Policia e Kosovës

MPB përkatësishtë, Policia e Kosovës konformë përgjegjësi të saja ligjore ka zhvilluar aktivitete policore në plotësim të kompetencës ligjore për zbatimin e ligjit dhe angazhimit për bashkëpunim dhe koordinim me subjektet tjera me qëllim të arritjes së objektivave për parandalim, mbrojtje, rehabilitim dhe re-integrim të viktimave.

Përfaqësuesit e Policisë kanë marrë pjesë në shumë konferenca, ku është trajtuar fenomeni i dhunës familjare, kanë marrë pjesë në punëtori të ndryshme me institucionet tjera që trajtojnë dhunën në familje, kanë dhënë kontribut për hartimin e Udhëzimeve Administrative, etj.

Me rastin e ditës ndërkombëtare kundër dhunës në familje “16 ditët e aktivizmit”, ka organizuar disa Konferenca me qëllim të parandalimit, vetëdijësimin dhe senzibilizimit për dhunën në familje, si: Konferencë në Pejë me temën “Trajtimi i dhunës në familje nga institucionet”, Konferencë në Prishtinë me qëllim të vetëdijësimin për drejtat ligjore për viktimat e dhunës në familje me përfaqësues nga shoqëria civile dhe zyrtarët e institucioneve që trajtojnë dhunën në familje. Konferencë për media për “Lansimin e Pilot-projektit për dhomat e intervistës për viktimat e dhunës në familje” dhe Konferencë për media për lansimin e pilot-projektit “Mbajtja e ligjeratave në shkollat fillore në Podujevë e Obiliq”.

Pjesëmarrja në emisione mediale ku është trajtuar dhuna në familje për vetëdijësimin e qytetarëve në: RTK, TV21, RROKUM TV, Radio Evropa e Lirë dhe në të përditshmet, Kosova Sot, Epoka e Re, Koha Ditore, etj.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

Në vazhdimësi të punës së saj për parandalimin e dhunës në familje dhe trafikimin, MASHT-i brenda përgjegjësiave të saja ligjore ka realizuar këto aktivitete:

- Tema e dhuna në familje, vazhdon të jetë pjesë e planprogrameve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit.

- Ka realizuar më se 10 punëtori me 360 nxënës të 6 (gjashtë) komunave, ku është diskutuar për rolin e shkollave për identifikimin dhe raportimin e dhunës në familje.

- Ka organizuar gara të ndryshme nëpër shkolla kundër trafikimit me njerëz dhe ka shpërndarë dhurata për fituesit e këtyre garave.

- Ka finalizuar protokollin kundër dhunës në familje ku parashihet raportimi i dhunës në familje.

- Ka zhvilluar aktivitete të ndryshme në shkolla me rastin e "ditës së vajzave".

- Për "1 Qershorin" ditën ndërkombëtare të fëmijëve mbajti konferenca me nxënës me temën "të drejtat e mia".

- Për 8 Marsin si (Dita ndërkombëtare e Gruas), organizoi debat me temën "vendimarrja në arsim".

- Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme në shkolla me rastin e 16 ditët e aktivizmit dhe për javën e viktimave të krimit.

- në shkollat e Kosovës janë aktiv rreth 140 pedagog – psikolog.

Për fushat 16 ditët e aktivizmit për dhunën në familje ishin të planifikuara nga MASHT-NJDNJ, gjegjësisht zyrtarja për Barazi Gjinore, aktivitete nëpër shkolla, e që u mbajtën me klasat e nënta dhe me Parlamentin e nxënësve, me Komitetin e shkollës dhe me Organizatën për të drejta dhe liri të fëmijës.

Më 06.12. 2012- në shkollën " Hilmi Rakovica" Prishtinë dhe më 07.12.2012 në shkollën "Bedri Gjikja" Mitrovicë.

Aktivitetet ishin ligjërata informuese për dhunën në familje, e cila si pasojë sjellë edhe dhunën në shkollë, pastaj u fol me nxënës për dhunën, se dhuna në familje nuk është vetëm ndaj gruas por edhe ndaj anëtarëve tjerë të familjes babait, nënës vëllait motrës etj.

Gjithashtu ka marrë pjesë në takimet e rregullta të Grupit për çështje Gjinore në arsim duke kontribuar për perspektivën gjinore brenda sistemit arsimor.

Krahas angazhimeve tjera, vlen të përmendet bashkëpunimi me komisionin parlamentar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione dhe me shumë organizata vendore e ndërkombëtare që punojnë në çështjet gjinore.

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve

Në kuadër të shtyllës së parandalimit, MKRS synon të identifikoj mënyrat për edukimin dhe vetëdijësimin e shoqërisë për dhunën në familje dhe pasojat e saj.

Në kuadër të senzibilizimit të opinionit shoqëror për rolin dhe rëndësinë e pozitës së gruas në shoqëri, përmes krijimtarisë artistike ka reflektuar në fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe luftimin e stereotipeve gjinore për parandalimin e dhunës në familje. Teatri Kombëtar i Kosovës në kuadër të fushatës për “ditët e aktivizmit” ka shfaqur komedinë “Lisistrata” e që shpreh protestë kundër luftës dhe vetëdijësimit të njerëzve për të krijuar paqe.

Ministria gjithashtu ka monitoruar shtypin ditor gjatë fushatës “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në familje” me qëllim të analizimit të sasisë dhe cilësisë së shkrimeve duke ditur që edhe mediat nxisin opinionin dhe zhvillojnë debatin për efikasitet kundër dhunës në familje.

Përfaqësuesit e Ministrisë kanë marrë pjesë në trajnime dhe tryeza të caktuara ku është trajtuar dhuna në familje, mbrojtja dhe raportimi i saj në mediat e Kosovës.

Prokurori i Shtetit

Nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV) në përmbushje të përgjegjësisë ligjore dhe sipas Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit janë kryer shumë aktivitete për mbrojtjen e drejtave të viktimave dhe ofrimit të shërbimeve të strehimit, përkujdesjes mjekësore dhe nevojave tjera të viktimave.

Janë ofruar shërbime 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës, në tërë territorin e Kosovës, është realizuar informimi mbi të drejtat ligjore dhe këshillim në secilin rast të viktimave të dhunës në familje, si dhe përpilim të kërkesave për urdhër mbrojtje, urdhër mbrojtje emergjente dhe padi të ndryshme. Ka shoqëruar dhe përfaqësuar viktimat në polici, prokurori dhe gjykata. Ka referuar dhe realizuar edhe përkrahje psiko-sociale, mjekësore dhe të strehimit për viktimat e dhunës në familje.

Kanë punuar në 868 raste të dhunës dhe kanë inicuar 410 urdhëra mbrojtës (68 urdhëra mbrojtës emergjent dhe 342 urdhëra mbrojtës, të inicuar) dhe gjykatat kanë lëshuar 292 urdhëra për mbrojtje ku MV-të kanë përfaqësuar këto viktimat në seanca gjyqësore. MV-të kanë shoqëruar dhe strehuar 126 raste të dhunës në familje në strehimore të ndryshme.

MV-të kanë marrë pjesë në të gjitha aktivitetet kundër dhunës në familje dhe hartimin e dokumenteve të ndryshme me akterë të ndryshëm dhe kanë ndjekur trajnimet në çështjen e dhunës në familje.

Aktivitetet e Zyrës së Prokurorit të Shtetit në shtyllën e parandalimit kanë qenë të shumta, duke filluar nga organizimi i Konferencës me rreth 250 pjesëmarrës **“Javës për të drejtat e viktimave të krimit”** nën patronazhin e Kryeprokurorit të Shtetit me moton **“Mbrotjtja e Viktimave të Krimit – Detyrimi ynë”**. Qëllimi i kësaj koference ka qenë vetëdijësimi i opinionit publik për të drejtat e viktimave, trajtimi, mbrojtja dhe rehabilitimi i tyre.

Nga kryeprokurori i Shtetit, është vizituar strehimorja për rastet e dhunës në familje në Gjakovë, me ç'rast është mbajtur një tryezë e rrumbullakët në Prokurorinë e Gjakovës me temën **“trajtimi i rasteve të dhunës në familje”**.

Në kuadër të fushatës, një konferencë iu është dedikuar fëmijëve, ku kanë marrë pjesë fëmijët nga 38 komuna, ndërsa 3 nga ta si panelist, kanë mbajtur prezantime për fenomenin e dhunës në familje.

Në kuadër të vetëdijësimit është zhvilluar një debat në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe ofrimit të shërbimeve nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në RTV 21.

Gjithashtu, ZMNv ka marrë pjesë në emisionin **“Në kërkim”** i cili u transmetua nga RTK-ja e që u debatua për punën e mbrojtësve të viktimave dhe për një rast konkret të dhunës në familje.

Gjatë vitit 2012 Prokuroritë kompetente kanë pranuar 477 raste të kallëzimeve penale, ndërsa nga viti paraprak janë trashëguar edhe 120 raste, ndërsa gjatë këtij viti është vendosur për 581 kallëzime penale dhe atë si në vijim :

- Për 96 persona janë hedhur kallëzimet penale,
- Për 2 persona janë pezulluar hetimet,
- Për 6 persona është hequr dorë nga ndjekja penale,
- Kundër 293 personave është paraqitur Propozim-akuzë,
- Kundër 80 personave është paraqitur Propozim-akuzë për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor.
- Kundër 14 personave është paraqitur Aktakuzë e drejtëpërdrejtë,
- Kundër 21 personave është paraqitur Aktakuza pas hetimit,
- Kundër 15 personave , kallëzimi penal është zgjidhur në mënyrë tjetër dhe
- 54 persona janë dërguar në kompetencë.

Për persona të mitur këtë vit janë pranuar 11 raste të kallëzimeve penale, ndërsa janë trashëguar 3 raste nga viti paraprak, Prokuroritë këtë vit kanë vendosur për 9 raste dhe

kundër 7 personave kanë hudhur kallëzimet penale, ndërsa kundër 2 personave është propozuar shqiptimi i masës edukative.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE)

Gjatë vitit 2012, Sektori për Barazi , jo-diskriminim dhe kundër-trafikim me qenie njerëzore në OSBE, në koordinim dhe bashkëpunim me ABGJ ka implementur projektin "Rritja e përgjegjshmërisë ndaj barazisë gjinore dhe çështjeve të dhunës në familje në Kosovë".

Si pjesë e projektit të lartëcekur janë zhvilluar trajnime me punëtor social në nivel të Kosovës të përfshirë në trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe përfaqësues të strehimoreve.

Në bashkëpunim me zyren për mbrojtje dhe përkrahje viktimave, është organizuar trajnim për rolin dhe përgjegjësitë e tyre, bazuar në ligjin në fuqi.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës është organizuar trajnim i zyrtarëve policor nga njësitet kundër dhunës në familje për përgjegjësitë e tyre që dalin nga Ligji për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje. Në këtë trajnim njëditor morën pjesë rreth 120 zyrtar policor.

Gjatë vitit 2012, OSBE ka mbështetur në forma të ndryshme, Linjën Ndihmëse për rastet e trafikimit dhe dhunës në familje, që funksionon në kuadër të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave/Prokuroria e Shtetit, përmes fushatave sensibilizuese: TV dhe Radio debateve, TV dhe Radio reklamave; shpërndarjes së posterëve dhe broshurave me mesazhe kundër dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore si dhe informata rreth funksionimit të kësaj linje.

Në bashkëpunim me UNDP dhe ABGJ-në u organizua trajnim njëditor me gazetarët e angazhuar në fushën e dhunës në baza gjinore.

Gjatë fushatës 16 ditëshe kundër dhunës ndaj gruas, OSBE-Sektori i Barazisë, kundër-Diskriminimit dhe Trafikimit me Qenie Njerëzore, ka organizuar trajnim mbi integrimin gjinor në legjislacion dhe politika për stafin e komunave dhe të nivelit qendror. Trajnimi u mbajt në të gjitha regjionet e Kosovës, nga një ekspert i jashtëm në çështjet gjinore, i angazhuar nga OSBE me ç'rast përfituan rreth 80 pjesëmarrës në fushën e çështjeve gjinore.

OSBE ka përfaqësues në Grupin Koordinues Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje përmes të cilit është duke e mbështetur dhe është pjesë aktive për realizimin e Programit të Kosovës dhe Planin e Veprimit 2011-2014 kundër dhunës në familje.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI Plus)

UNDP si partner ndërkombëtar ndihmon vendet në zhvillimin dhe në ndërtimin e kapaciteteve kombëtare për të arritur zhvillim të qëndrueshëm njerëzor, në edukim, punë, shëndet etj.

UNDP, projekti WSSI në kuadër të objektivit të dytë të saj ka: zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014. Në kuadër të objektivit të pestë të saj (ngritja e vetëdijësimit të popullatës mbi dhunën në baza gjinore) WSSI plus, ka:

- Në muajt, Shkurt - Maj 2012 ka monitoruar tetë gazeta ditore lidhur me raportimin e tyre në sferën e dhunës në baza gjinore, dhe ka gjetur se raporti është informues por jo edhe edukativo/vetëdijësues.

- Ka organizuar një tryezë me redaktorët e të gjitha formave mediatike në vend, me qëllim të nxjerrjes së rekomandimeve lidhur me përmirësimin e raportimit të dhunës në baza gjinore me qëllim të vetëdijësimit të popullatës në Kosovë.

- Në bashkëpunim me Grupin e Grave Parlamentare ka organizuar tryezën me temën ``Gratë në Kosovë dhe qasja e tyre në Drejtësi``

- *Gjatë 16 ditëve të aktivizmit ka zhvilluar dhe organizuar shumë aktivitete:*

- Ka mbështetur Koordinatorin Nacional për Organizimin e takimit konstitues të Grupit Koordinues Ndër-Ministror dhe mbajtjen e tryezave për hapjen dhe mbylljen e fushatës.

- Në bashkëpunim me PK dhe OJQ-në ``Zana`` ka organizuar dy debate me përfaqësues të shoqërisë civile në Prishtinë dhe Pejë.

- Në bashkëpunim me ABGJ-në ka vendosur reklama me slloganin ``Komuniko me fjalë e jo me dhunë`` në komunat e Kosovës (Mitrovicë, Drenas, Podujevë, Fushë Kosovë, Gjakovë, Pejë, Lipjan, Prizren, Dragash, Ferizaj, Shtime, Gjilan, Malishevë, Rahovec, Graçanicë).

UNDP, WSSI Plus kanë implimentuar edhe shumë aktivitete tjera që do të paraqiten në këtë raport me vonë, këtu janë përfshirë aktivitetet në fushën e parandalimit.

Programi i UNKT-së mbi Dhunën në Familje në Kosovë

Programi i Përbashkët mbi Dhunën në Familje në Kosovë është dizajnuar nga Task Forca e KB-së mbi Dhunën në Bazë Gjinore (DhBGj), që përbëhet nga UNDP, UNFPA, UNICEF, UN

Women dhe OHCHR, nën udhëzimin dhe përgjegjësinë e plotë të Koordinatorës së KB-së për Zhvillim, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës. Konsultimet kanë përqëndruar në vlerësimin dhe legjitimimin e fushave kryesore për të mbështetur zbatimin e Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje (PKPVDHF) 2011-2014, në përputhje me mangësitë dhe sfidat e identifikuar gjatë adresimit të DhBGj-së në Kosovë, dhe e cila është mbështetur nga Programi i Përbashkët i UNKT-së mbi DhBGj-në.

Programi i Përbashkët mbi DhBGj-në i UNKT-së ka mbështetur zbatimin e PK dhe PVDHF përmes miratimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse për të adresuar dhunën në familje në tri pilot komuna. Në reagim të shqetësimeve të ngritura gjatë procesit të zgjeruar konsultativ, programi ka nxjerrë këto objektiva të përgjithshme:

1. Ngritja e vetëdijes mbi DhF-në dhe përmirësimi i qasjes në shërbime për të mbijetuarat e dhunës në familje në pilot komuna;
2. Fuqizimi i zinxhirit të shërbimeve formale/joformale për parandalimin e DhF-së, shërbimet e mbrojtjes dhe re-integritimit përmes intervenimeve efektive në pilot komuna;
3. Fuqizimi i pavarësisë ekonomike për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe ofrimin e këshillave për familjet dhe kryesit e veprave;
4. Shpërndarja e rezultateve të programit, duke përfutur nga mësimet e nxjerra dhe shpërndarja e tyre në komunat e tjera.

Ngushtë e lidhur me mbështetjen për implementimin e PKPVDHF, ky program parasheh përmbushjen e objektivave përmes katër metodave kyçe për intervenim:

a) Parandalimi: ngritja e vetëdijes mes grave/vajzave dhe burrave/djemve mbi DhF-në dhe të drejtat e grave në pilot komunat;

b) Mbrojtja: shtimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë financiare për mekanizmat mbrojtës të DhF-së për të ofruar shërbime cilësore në pilot komunat;

c) Re-integrimi: ngritja e pavarësisë ekonomike për të mbijetuarit (potencial) të DhF-së dhe këshillë-dhënia për familjet dhe kryesit e veprave të dhunës; dhe

d) Përmbyllja: shpërndarja, legjitimimi, dhe përsëritjes së rezultateve të programit dhe mësimet e nxjerra përmes dialogut të politikave mes palëve të interesit në nivele të ndryshme.

Gjatë periudhës raportuese, UNDP ka zbatuar një aktivitet me një aranzhim alternativ financimi për projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjinore”, zbatuar nga UNDP dhe financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës.

Në tremujorin e parë të vitit 2012, për të mbështetur komponenten e Re-integritimit Ekonomik të Programit, pas një rekomandimi nga donatori, ofroi mbështetje për zyrat ligjore, përmes Projektit të UNDP-së “Avancimi i Drejtësisë Gjinore” e cila është realizuar gjatë

periudhës raportuese përmes projektit të UNDP-së. Rialokimi i fondeve ka mundësuar implementimin e aktivitetit për *Lidhjen e ndërmarrjeve me të mbijetuarat nga DhF në tri Pilot Komunat* i cili është shtuar në Planin e Përbashkët Vjetor të Punës me kërkesën e donatorit, dhe ka filluar në tremujorin e fundit të vitit 2012.

Aranzhimet për zbatim dhe monitorim

Mbikëqyrja e përgjithshme e programit është bërë nga Bordi i Programit.

UNICEF: Anketa e përgjithshme është zhvilluar nga partneri implementues “FTK” në konsultim të ngushtë dhe nën monitorimin e stafit të programit të UNICEF-it dhe të tre KKP-ve.

UNDP, ka zbatuar katër aktivitete gjatë periudhës raportuese. Për identifikimin e shërbimeve sociale, të zbatuar në tremujorin e parë, dhe identifikimin e shanseve ekonomike të zbatuar në tremujorin e katërt 2012.

Për trajnimin e zyrtarëve ligjor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe përfaqësuesit e Odës së Avokatëve të Kosovës nga tre pilot komunat, është angazhuar një trajnues nacional për periudhë afatshkurtër. Aktiviteti i katërt, ‘Lidhja e ndërmarrjeve me të mbijetuarat nga DhF-ja në Tri Pilot Komunat’, është përgatitur nga stafi i Programit të DhBGj-së me mbështetjen e UNDP-së gjatë tremujorit të tretë 2012, duke filluar periudhën implementuese nga tremujori i katërt në vitin 2012. Ky aktivitet është në zhvillim e sipër.

UN Women: Puna e konsulentëve, ndërmejtësuesve dhe trajnuesve të rekrutuar nga UN WOMEN për të përgatitur dhe shpërndarë: raportin për *“Alokimi i buxhetit për shërbimet në DhF në nivelin komunal; funksionimin e mekanizmave bashkërendues dhe njohurive mbi DhBGj-në”*, përpilimin e Kushteve të punës, dhe *Procedurat Standarde të Operimit (PSO për MB mbi DhF-në)*, *Raportet për Vlerësimin e Nevojave të Kapaciteteve* për MB në DhF-në, seminare mbi *BPGj-në* dhe *Doracaku i BPGj-së ...* të gjitha janë zhvilluar nën mbikëqyrjen e stafit të programit të UN Women dhe tre KKP-ve.

UNFPA: Aktivitetet që kanë të bëjnë me sektorin e shëndetësisë dhe OJQ-të janë drejtpërsëdrejti të zbatuara nga partneri implementues, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK). Aktivitetet edukative teatrore janë zbatuar nga Qendra për Zhvillimin e Arteve – Artpolis. Sistemi efektiv monitorues është siguruar përmes takimeve të rregullta me RrGK-në dhe Artpolis, vizitave në terren dhe takimeve pasuese pas aktiviteteve, përfshirë këtu edhe punën pasuese përmes KKP-ve.

OHCHR: Konsulenti ndërkombëtar përgjegjës për të punuar në raportin studimor mbi të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë konfliktit, ka kryer punën nën mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e ngushtë me stafin e programit të OHCHR.

Në muajin shkurt dhe mars 2012, janë organizuar tri ngjarje për lansimin e programit të DhBGj-së në komunën e Gjilanit, Gjakovës dhe Dragashit. Pjesëmarrja në të tri ngjarjet ishte e lartë dhe përfshinte edhe përfaqësuesit e autoriteteve komunale, policinë, gjykatat/prokuroritë, qendrat për punë sociale, zyrat për ndihmë juridike, avokatët e viktimave, strehimoret e grave, OJQ-të lokale dhe stafin nga agjencitë implementuese.

Delegacioni nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës kanë vizituar Kosovën në javën e parë të nëntorit 2012, ku zhvilloi takim me strukturat komunal të Gjilanit dhe vizitoi strehimoren e grave “Liria” në Gjilan. Në të dyja takimet, delegacioni pati mundësinë të marrë informata për implementimin e aktiviteteve të programit, ndikimin e tyre, por edhe të mësojnë më shumë për çështjet e DhF-së në komuna dhe sfidat me të cilat ata ballafaqohen gjatë adresimit .

KNP, KKP dhe stafi i Agjencive zhvilluan takime të rregullta me përfaqësuesë të organizatave të ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare dhe agjencitë tjera për të koordinuar aktivitetet në lidhje me Programin e DhBGj-së.

Pas themelimit të Grupit Koordinues Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje në Kosovë, dhe ftesën nga ana Koordinatorit Nacional, për Koordinatorin Nacional kundër DhF-së në Agjencitë e KB-së, për t’iu bashkëngjitur Grupit në kapacitetin e ekspertit/vëzhguesit, Koordinatorja për Zhvillim e KB-së emëroi KNP-në e DhBGj-së që të përfaqësojë të pesë agjencitë e KB-së për DhBGj-në në këtë mekanizëm. KNP do të shërbejë si një urë komunikimi mes Grupit Koordinues Ndër-Ministor dhe pesë agjencive të KB-së, për të prezantuar qëndrimet dhe rekomandimet e tyre në këtë mekanizëm.

UNICEF-i, ka zhvilluar një studim/anketë gjithëpërfshirëse mbi: praninë e dhunës, vlerat familjare, pikëpamjet, pasojat, faktorët e rreziqeve, reagueshmërinë e komunitetit dhe shërbimet e ofruara për DhF/DhBGj në tri pilot komuna.

Gjatë vitit 2012, Zyra e OHCHR në Kosovë inicioi një studim gjithëpërfshirës për dhunën e bazuar seksuale (DhBS) që ka të bëjë me konfliktin në të kaluarën. Qëllimi i studimit është identifikimi i mangësive në legjislacion dhe rekomandimi i hapave që duhet ndërmarrë sa i përket qasjes në kompensim dhe reparacion.

Ky studim do të finalizohet në fillim të 2013 dhe do të shërbejë si një mekanizëm avokues i bazuar në dëshmi i cili do të informojë legjislativin dhe politikë bërjen e ardhshme lidhur me reparimin për të mbijetuarit e DhBS-së.

Në mënyrë që të mbulohen të gjitha pasojat afatgjate të dhunës seksuale, qasja në të gjitha shërbimet dhe strategjitë e mbijetesës si dhe nevojat e reparacionit, ekipi hulumtues ka parashtruar pyetjen udhëzuese për gjithsej 38 të mbijetuarat të dhunës seksuale nga gjithsej tri komuna/grupet e komunave : Gjakovë, Deçan, Drenas, Fushë Kosovë, Klinë dhe Prishtinë.

Në tremujorin e katërt 2012, UNDP organizoi një trajnim njëditor për zyrtarët ligjorë të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe përfaqësuesit e Odës së Avokatëve të Kosovës nga tri pilot komunitet ku u prezantua korniza legjislative e Kosovës në lidhje me Dhunën në Familje, përfshirë këtu legjislacionin primar dhe sekondar, si dhe u shpalos Programi i Kosovës dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014 para partnerëve të sipër përmendur, me theks të veçantë për rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve që ofrojnë shërbime në fushën kundër dhunës në familje. Gjithsej 20 pjesëmarrës morën pjesë në trajnim.

UNFPA – Zhvilloi fushatat në nivel të komunitetit për të shtuar vetëdijësimin e popullatës në tri pilot komunitet në lidhje me DhF/DhBGj-në.

Në kuadër të aktiviteteve për përafrim me komunitetin në terren UNFPA ka kontraktuar OJQ-në “Artpolis” për të zhvilluar aktivitete edukative teatrore për të adresuar DhBGj-në në tri komunitet. Janë organizuar tri trajnime edukimi të bazuara në teatër në Gjiçan, Gjakovë dhe Dragash (për të rinjtë shqiptarë dhe goranë) gjatë muajve korrik-shtator 2012

UN Women – Zhvilloi Analiza të politikave gjinore në nivelin komunal dhe alokimin e buxhetit për politikën dhe aktivitetet relevante.

Sipas të të gjeturave të raportit, ka hapësirë për lobim dhe angazhim të shtuar për Zyrtarët komunal për Barazi Gjinore dhe shoqërinë civile që të fitojnë fonde nga komunitet, me kusht që nevojat të jenë mirë të prezantuara dhe të mbështetura me arsyetime të mirëfillta.

UN Women – Zhvilloi aktivitete Trajnimi mbi BPGj-në, zhvillimi i moduleve për KeP, trajnimet mbi BpGj-në dhe studimi. Trajnimi mbi BRGj-në u mbajt në tetor si dhe më 5-7 nëntor 2012, me pjesëmarrës nga MK-të .

Në tremujorin e parë, UNDP ka përfunduar aktivitetin e paraparë për identifikimin e shërbimeve formale dhe joformale sociale që janë në dispozicion për të mbijetuarat, dhe të mbijetuarat potenciale nga DhF-ja në tri pilot komunitet e Programit të Përbashkët. për të parandaluar dhe reagu ndaj DhF-së, përfaqësuesit e OJQ-ve aktive në këtë fushë, përfshirë edhe përfaqësuesit e departamenteve kryesore në tri komunitet, që tashmë janë të involvuar në parandalimin dhe reagimin ndaj DhF-së.

UNICEF – Organizoi Zhvillimin e kurrikulave dhe trajnimet e avancuara për profesionistët e shërbimit social. Derisa në të kaluarën, si pjesë e aktivitetit, janë mbajtur takimet koordinuese, sfida me të cilën ballafaqohen shërbimet sociale për shkak të procesit të decentralizimit ka rezultuar të jetë në mungesën e një agjencie e cila do të merrte përgjegjësinë për zbatimin e programeve trajnuese për ofruesit e shërbimeve sociale, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) aktualisht nuk posedon me një program funksional trajnimi në kuadër të shërbimit të brendshëm.

UNFPA –Zhvilloi aktivitete për Përpilimin e kurrikulave dhe protokolleve, trajnimi u mbajt për profesionistët në shërbimin shëndetësor mbi DhBGj/DhF-në .

Grupi Punues i ekspertëve (GP) (të emëruar në Ministrisë e Shëndetësisë) për zhvillimin e udhëzimeve për ofruesit e kujdesit shëndetësor ka përfunduar draftin final.

UNFPA, ka organizuar seanca trajnimi për OJQ-të lokale dhe palët tjera relevante të interesit për të diskutuar legjislacionin aktual mbi DhF-në, mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira të cilat kontribuojnë në adresimin, avokimin dhe koordinimin e përpjekjeve në fushën e DhBGj-së.

Pas kësaj, janë mbajtur tri seanca dyditore të trajnimit në Gjakovë, Gjilan dhe Dragash. Seancat e trajnimit adresuan çështjen e DhBGj,-së legjislacionin aktual, mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira që kontribuojnë në adresimin, avokimin dhe bashkërendimin e përpjekjeve ndaj DhBGj-së. Pjesëmarrësit në trajnime ishin përfaqësues të OJQ-ve vendore, OJQ-ve rinore, strehimoreve të grave dhe zyrtarëve nga Prokuroria, Kuvendi Komunal, Policia, Drejtorati për Arsim, Drejtorati për Shëndetësi, Punë Sociale dhe Mirëqenie, etj.

UN Women – Ka siguruar Blerjen e pajisjeve teknike për njësinë policore kundër DhF-së, në të tri komunat dhe pas mobilimit dhe pajisjes për tri dhoma hetimore ``miqësore ndaj fëmijëve`` në stacionet policore të tri komunave, Policia e Kosovës (Njësia kundër DhF-së) dhe UN WOMEN ka organizuar një ceremoni për të shënuar inaugurimin e tyre.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2012, UNDP në fushën e Ri-integritit ,ka bërë identifikimin e mundësive ekonomike për të mbijetuarat nga DhF-ja në tri pilot komunat. Ndërsa gjatë periudhës raportuese, UNDP dhe Stafi i Programit ndaj DhBGj-së ishin të angazhuar në përpilimin dhe planifikimin e aktivitetit të ri të shtuar që adreson komponentën e ri-integritit të programit të përbashkët. Ky Aktivitet ka filluar në tremujorin e fundit të vitit 2012.

Duke u bazuar në modelin dhe përvojën e Programit të UNDP për Tregun Aktiv të Punës (PTAP) qëllimet kryesore të Aktivitetit janë ofrimi i trajnimeve dhe punësimit për të mbijetuarat nga tri pilot komunat.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

RrGGK është rrjet joformal i grupeve të grave dhe organizatave të regjioneve të ndryshme të Kosovës. Duke përfaqësuar një numër të madh të organizatave anëtare, ajo përkrahë, mbronë dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave. Në bazë të Planit Strategjik të saj angazhohet edhe kundër Dhunës në Familje dhe kundër Trafikimit.

Qëllimi afatgjatë i këtij Rrjeti është që gratë të jetojnë një jetë të lirë, pa dhunë në familje dhe pa trafikim dhe synon të përmirësojë zbatimin e legjislacionit kundër trafikimit dhe dhunës në familje si dhe për të rritur vetëdijën e publikut në lidhje me legjislacionin në fuqi.

Ambasada e SHBA-së në Kosovë

Ambasada Amerikane, Departamenti i Drejtësisë - Programit për Mbrojtjen e Viktimave gjatë vitit 2012 ka realizuar:

- Ka përkrahur emërimin e Koordinatorit Nacional në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë,
- Në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe UNDP/ WSSI, ka inicuar dhe përkrahur gjithë procesin e hartimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,
- Ka përkrahur Zyren e Kryeprokurorit të Shtetit në mbajtjen e “Javës për të drejtat e viktimave të krimit” gjatë muajit Tetor 2012,
- Ka botuar postera për të drejtat e viktimave,
- Ka botuar nje libërth për fëmijët viktima,
- Ka përkrahur PK në printimin e fletushkave për të drejtat e viktimave të dhunës në familje.

Mediat

Kanë rol të rëndësishëm në krijimin dhe promovimin e një opinionit të fuqishëm shoqëror kundër dhunës në familje. Ato duhet të jenë më të ndjeshme ndaj fenomenit të dhunës në familje, më këmbëngulëse në promovimin e vlerave të familjes dhe të kenë qëndrim të prerë kundër stereotipeve me bazë gjinore. Informimi mbi dhunën në familje nga ana e mediave ka rëndësi të veçantë për qasjen në mënyrë kritike ndaj fenomenit, por edhe për përcjelljen e mesazheve në dobi të vetëdijesimit të popullatës e sidomos të brezit të ri. Megjithatë jo gjithmonë raportimi i dhunës bëhet konform etikës profesionale, në jo pak raste, dhuna në familje është përdorur si rast gazetaresk e jo si mënyrë kritike për t'ju qasur fenomenit dhe për të sensibilizuar opinionin publik.⁵

Megjithatë, niveli i bashkëpunimit është rritur dukshëm, kjo vërehet edhe në organizimin e tryezave, trajtimin e temave të ndryshme, nga akterët, në lidhje me dhunën në familje dhe reklamimet e ndryshme për sensibilizimin e opinionit publik, në mediat e shkruara dhe ato elektronike.

⁵Raporti i KSK, faqe 36

Kampanja e 8 Marsit dhe 16 ditët e aktivizmit

Kampanja e 8 Marsit

8 Marsi, si ditë e unitetit të grave dhe vajzave në kërkim të të drejtave të tyre për shkollim, avancim, dhënjen e kontributit të tyre në shoqëri, për të vendosur vetë për jetën e tyre, u shënua në mënyra të ndryshme. Me një ceremoni misioni i OSBE-së (Sektori për Barazi, kundër-Diskriminim dhe kundër-Trafikim me Qenie Njerëzore, në bashkëpunim me ABGJ-në) kanë shënuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me ç'rast është lansuar katalogu për këshillë dhe asistencë për viktimat e dhunës në familje dhe raporti "Gjykimi i Peticioneve për Urdhërat Mbrojtës për Rastet e Dhunës në Familje në Kosovë" si dhe filloi kampanja vetëdijësuese e OSBE-së për të promovuar dhunën në familje dhe linjën ndihmëse të anti-trafikut.

WSSI plus në bashkëpunim me Grupin e Grave Parlamentare, me 8 mars 2012, organizoi tryezën me temën "Gratë në Kosovë dhe çasja e tyre në drejtësi" ku u nxorën rekomandime që lidhen me implimentimin e kornizës ligjore, të cilat sigurojnë drejtësi ndaj grave, e që u lexuan në Kuvendin e Kosovës.

Në Kosovë ekziston vullneti politik dhe Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në luftimin e fenomeneve të tilla dhe është duke promovuar arritjen e barazisë gjinore në shoqërinë tonë.

Fushata 16 ditët e aktivizmit

Fushata fillon me 25 Nëntor, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Grave dhe përfundon më 10 Dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, që nënkupton se dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut. Fushata organizohet në mbarë botën nga aktivistë të të drejtave të njeriut, duke bërë thirrje për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

Në vendin tonë u zhvilluan shumë aktivitete nga akterë të ndryshëm brenda këtyre ditëve :

Me rastin e fillimit dhe përmbylljes së fushatës "16 Ditët e Aktivizmit" Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje, organizoi dy Konferenca me temën: "Arritjet dhe implementimi i Planit Nacional dhe Strategjisë Kundër Dhunës në Familje për vitin 2012" dhe "Trajtimi i rasteve të dhunës në familje për vitin 2012". Me këtë rast, Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje potencoi se Kosova ka ndërtuar mekanizma ligjor-institucional, për parandalimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e shkaktarëve të dhunës në familje, re-integrimin e viktimave të dhunës, si dhe ngritjen e vetëdijës së qytetarëve për respektimin e normave ligjore në fushën e të drejtave të njeriut, por u theksua se as Kosova nuk mund të përjashtohet nga ky fenomen. Përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në fushatën kundër dhunës në familje, në këtë konferencë paraqitën aktivitetet e tyre, të realizuara posaqërisht gjatë kësaj fushate.

Pjesë e fushatës “16 ditët e aktivizmit” në Kosovë, ishin përfaqësues nga institucione publike, shoqëria civile, përfaqësues të mediave si dhe organizatave ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë. Fushata është mbështetur nga Ambasada Amerikane, Ambasada e Britanisë së Madhe, OSBE dhe UNDP.

Agjencia për Barazi Gjinore me rastin e fushatës 16 Ditët e aktivizmit, për eliminimin e dhunës ndaj grave, ka shpërndarë në 5 librari të qytetit kompletet të legjislacionit në fuqi, që rregullon mbrojtjen nga dhuna në familje. ABGJ,WSSI/UNDP kanë vendosur 25 reklama me moton “Komunikoj me fjalë jo me dhunë”. Gjithashtu kanë realizuar një videoklip në RTK, ku fytyrat publike kanë potencuar domosdoshmërinë e luftimit të kësaj dukurie negative.

Ndërsa OSBE, Sektori kundër-Diskriminimit dhe Trafikimit me Qenie Njerëzore ka organizuar trajnim gjinor në legjislacion dhe politika për stafin e nivelit qendror dhe atë komunal, në të gjitha regjionet.

Gjatë 16 ditëve të aktivizmit WSSI ka organizuar disa aktivitete: ka mbështetur zyrën e Kordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje, duke organizuar tryezat me rastin e hapjes dhe mbylljes së fushatës, në bashkëpunim me PK dhe OJQ-në “Zana” u organizuan debate me shoqërinë civile në Prishtinë dhe Pejë, me qëllim të mbledhjes së rekomandimeve lidhur me përgjegjësinë ndaj dhunës në familje.

Policia e Kosovës organizoi *Koferencën në Pejë*, me qëllim të parandalimit, vetëdijësimit dhe senzibilizimit për dhunën në familje (pjesëmarrëse 55 gra nga shoqëria civile) e që u trajtua tema “trajtimi i DHF nga institucionet”; *Koferencën në Prishtinë*, me qëllim të vetëdijësimit dhe njoftimit për të drejtat ligjore për viktimat e dhunës në familje, pjesëmarrës ishin përfaqësues nga shoqëria civile dhe zyrtar institucional që trajtojnë dhunën në familje; *Kofernecën për media* “Lansimi i pilot projektit për dhomat e intervistës për viktimat e dhunës në familje”; *Koferencë për media*, për lansimin e pilot projektit “Mbajtja e ligjeratave në shkollat fillore” në Podujevë dhe Obiliq me tematikën e dhunës në familje.

Aktivitetet e MKRS u shprehën në Teatrin Kombëtar të Kosovës, duke u shfaqur komedia “Lisitrata” që i dedikohet paqes dhe shprehë protestë kundër luftës, ndërsa zyrtarja për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta, analizoi shtypin ditor gjatë gjithë fushatës (25 nëntor - 11 dhjetor) ku analizoi 18 shkrime, e që rezultoi se media i ka kushtuar vëmendje kësaj problematike.

Njësia për të Drejtat e Njeriut, zyra për Barazi Gjinore pranë MASHT, zhvilloi aktivitetet e saja nëpër shkolla në Prishtinë dhe Mitrovicë. U mbajtën ligjerata informuese për dhunën në familje, u diskutua me nxënës për dhunën, u prezentuan shumë materiale për dhunën në familje (ligji, programet etj), u lexuan eset e orëve letrare të mbajtura nga nxënësit.

Nxënësit shqiptarë, boshnjak dhe rom ishin pjesëmarrës të këtyre aktiviteteve që përfunduan me organizimin e një kokteji.

Në bazë të të gjithë aktiviteteve të ndërmarrura nga ana e të gjithë akterëve, mund të nënvizohet se qasja ndaj dhunës mbi gratë dhe vajzat si shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ishte komponent kyç i 16 ditëve të aktivizmit.

Përmbledhja e aktiviteteve

“Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta” thuhet në Kartën e të Drejtave të Njeriut. Por, nuk mjafton që këto të drejta vetëm të njihen, ato do të duhej të respektohen, në këtë aspekt, jetike do të ishte ndërgjegjësimi i burrave dhe grave për pasojat që shkaktohen nga dhuna dhe diskriminimi, pasojat në familje dhe në vetë gruan.

Me aktivitete të ndryshme ndikohet në vetëdijësimin e popullatës, në përmirësimin e mentalitetit patriarkal, në vlerën dhe rëndësinë e femrës në familje.

“Arritjet e implimentimit të Planit Nacional dhe Strategjisë Kundër Dhunës në Familje për 2012” dhe “Trajtimi i rasteve të dhunës në familje për vitin 2012”, ishin dy koferenca që u mbajtën nga KNKDHf me ç’rast u shënua fillimi dhe përmbyllja e fushatës “16 Ditët e Aktivizmit” si dhe shënimi i ditës ndërkombëtare kundër dhunës në baza gjinore.

Në kuadër të aktiviteteve e me rastin e 16 ditëve, ABGJ shpërndau kompletet e publikimeve me legjislacionin në fuqi që ofrojnë mbrojtje nga dhuna në familje në 5 shkolla të kryeqytetit, pastaj në bashkëpunim me WSSI/UNDP në tërë vendin kanë vendosur reklama me moton “komuniko me fjalë jo me dhunë”. Krejt kjo me qëllim të ngritjes së vetëdijës së qytetarëve për pasojat e dhunës në familje dhe përkushtimin e të gjithëve për ta eliminuar këtë dukuri.

Programi i mëngjesit që trajtoi rastet e dhunës në familje, në RTV 21 dhe emisioni “në kërkim” në RTK, ishin aktivitete që u organizuan me qëllim të parandalimit dhe senzibilizimit të opinionit publik kundër Dhunës në Familje.

Qyteti i Prishtinës, Pejës, Podujevës dhe Obiliqit ishin pistat e PK, ku organizoi koferenca për trajtimin e dhunës në familje nga shoqëria civile dhe institucionet, ndërsa ata morrën pjesë në disa emisone mediale si dhe nga shtypi u trajtua e njejtja temë.

Dhuna në Familje, si temë vazhdon të jetë pjesë e planprogrameve mësimore në të gjitha nivelet, MASHT në këtë drejtim organizoi 10 punëtori në 6 komuna, me rreth 360 nxënës, me temën e të drejtave të fëmijëve si dhe identifikimi e raportimi i dhunës në familje. Organizoi gjithashtu aktivitete të ndryshme për “ditën e vajzave”, gara dhe koferenca me nxënës për të drejtat e tyre.

U organizuan, tryeza në Gjakovë, aktivitete me nxënës nga 38 komuna, debat në RTV21 me temën ofrimi i shërbimit për viktimat dhe temat tjera nga dhuna në familje, ishin aktivitete të ndërmarrura nga Prokurori i Shtetit.

Përveç aktiviteteve tjera të shumta të OSBE-së, veçojmë : trajnimet e gazetarëve për raportimin e dukurisë së dhunës në familje, debatet televizive, radio reklama, shpërndarjen e reklamave dhe broshurave me mesazhe kundër dhunës në familje.

Monitorimi i shtypit ditor, organizmi i tryezave , publikimet e aktiviteteve të KNKDHF, publikimi i fushatës së 16 ditëve të aktivizmit në gazetatat ditore dhe mediat elektronike, vendosja e reklamave **``komuniko me fjalë e jo me dhunë``**, mbështetja e zyrës së KNKDHF, ishin aktivitete të UNDP-WSSI dhe të ABGJ-së.

Një raport i monitorimit të Programit Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014, është përkrahur nga Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI Plus) e Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) e cila është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës.

Të gjitha veprimet e akterëve janë realizuar, duke u bazuar në objektivin e parë strategjik të parandalimit, me qëllim të ngritjes së nivelit të përmbushjes së objektivave specifike, të hartimit të politikave në nivel qendror dhe lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje, të sensibilizimit të shoqërisë mbi dhunën në familje, të krijimit të mekanizmave për edukimin dhe vetëdijësimin e të rinjëve dhe të rritjes së vetëdijes për raportimin e dhunës në familje.

Mbrojtja dhe Siguria

Mbrojtja dhe Siguria janë shtylla dhe objektivi i dytë strategjik i Programit Kundër Dhunës në Familje. Ajo do të përmbajë aktivitete të cilat do të ndikojnë në sigurimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, nëpërmjet shërbimeve ligjore dhe sociale adekuate, siç janë mbrojtja ligjore dhe ajo fizike.

Ndërsa objektivat specifik përfshijnë: sigurimin e shërbimeve efikase për mbrojtjen fizike të viktimave të dhunës në familje në të gjithë territorin e Kosovës; ngritja kapaciteteve të akterëve (policisë, prokurorisë, gjykatave dhe qendrave për punë sociale) për trajtimin e dhunës në familje; të sigurojnë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje.

1. Progresi i përgjithshëm në shtyllën e Mbrojtjes

Akterët kryesorë që luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve strategjike të objektivit të mbrojtjes janë: KNKDHF, MPMS, Prokurori i Shtetit - Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Policia e Kosovës, aktorët tjerë vendorë dhe ata ndërkombëtar.

Të gjithë aktorët kanë vazhduar t'i kryejnë obligimet e tyre ligjore me qëllim që të sigurohen mekanizma mbrojtës për viktimat (mbrojtja fizike). Policia e Kosovës, Prokuroritë, Gjykatat dhe QPS-të, të i ngrisin kapacitetet e tyre, ndërsa për viktimat e dhunës në familje të sigurohet ndihma juridike falas.

2. Aktivitetet kryesore

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), gjatë periudhës raportuese ka realizuar këto aktivitete në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsim Ligjor dhe Programit Trajnim i Trajnuesve:

- 1) Trajnim një ditorë me temë Mbrojtja nga Dhuna në Familje, i realizuar nga IGJK, pjesëmarrës ishin 17 gjyqtarë;
- 2) Në bashkëpunim me UNWOMEN, e IGJK ka realizuar: 3-trajtime regjinale dy ditore për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe pjesëmarrës të tjerë si avokat, mbrojtës të viktimave, zyrtar nga Minsitria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Polica e Kosovës, me tema mbi mbrojtjen nga dhuna në familje, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, instrumentet ndërkombëtare, çështjet pronësore dhe të trashëgimisë, gjithsejt 41 pjesëmarrës;
- 3) Në mbështetje të UNWOMEN, IGJK ka realizuar një punëtori treditore për trajnuesit e IGJK-së nga kjo fushë, dhe në kuadër të kësaj tryeze është hartuar moduli-kurrikula trajnuese me temat e cekura si në pikën 2. pjesëmarrës ishin 10 gjyqtarë dhe 5 të tjerë, gjithsejt 15 trajnues të IGJK-së nga kjo fushë;
- 4) Në bashkëpunim me UNDP- Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI Plus), IGJK ka realizuar tri trajnime një ditore me temë Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, masat mbrojtëse, bashkëpunimi i aktorëve dhe institucioneve të drejtësisë në mbrojtje nga DHF. Pjesëmarrës ishin gjyqtarë të fushës civile dhe penale, prokuror, avokat dhe mbrojtës të viktimave, gjithsej 66 pjesëmarrës.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Kodi i Procedurës Penale dhe Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, duke mbrojtur të drejtat e viktimave dhe ofruar shërbime tjera në strehim dhe përkujdesje mjekësore (24 orë në ditë), varësisht prej nevojave të tyre. ZMNV ka marrë pjesë me 20 zyrtarë në trajnimin e organizuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë me temën ``viktimizimi i fëmijëve`` përfshirë ata të dhunës në familje.

Trajnimi me temën ``Shkathtësitë në ndërmjetësimin dhe trajtimin e dhunës në familje`` u organizua nga Partner-Kosova/Qendra Për Administrimin e Konfliktëve, të përkrahur nga Ambasada Britaneze në Prishtinë. Gjithashtu këta zyrtar kanë marrë pjesë edhe në trajnimet e organizuara nga IGJK-ja.

Në kuadër të aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve policore për hetuesit e dhunës në familje. Policia e Kosovës ka realizuar disa projekte në bashkëpunim me UNDP, UN-WOMEN, si në trajnimin e zyrtarëve policor poashtu edhe në pajisjen e tri dhomave të intervistës për viktimat e dhunës familjare dhe janë në proces të sigurimit të pajisjeve shtesë për njësitet policore që mirren me luftimin e kësaj dukurie në përkrahje nga UNDP-ja.

MPMS / Departamenti për Mirëqenie Sociale gjatë vitit 2012, ka realizuar kontrata dhe marrëveshje për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje në 6 strehimore, anëtare të Koalicionit të Strehimoreve të Kosovës.

Strehimoret e KSK-së ofrojnë shërbimet e tyre për viktimat e dhunës në familje, si në stehim dhe siguri të lartë për viktimat e dhunës në familje gjatë qëndrimit në strehimore, sigurimi i ushqimit, sigurimi i mjeteve higjienike, medikamenteve mjekësore, këshillimit dhe mbështetjes emocionale, i transportit dhe komunikimit, i aktiviteteve rehabilituese/relaksuese, për ngritje profesionale, i materialeve shpenzuese për punë dore etj.

WSSI ka mbështetur financiarisht Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (strehimorja në Prishtinë) me 30.000,00 €, gjatë 2011 e deri në Prill 2012.

OSBE, Sektori për Barazi, jo-Diskriminim dhe kundër-Trafikim me Qenie Njerëzore, ka zhvilluar aktivitete të ndryshme në trajnimin e punëtorëve social dhe përfaqësuesve të strehimoreve, trajnimin e mbrojtësve të viktimave, trajnimin e policisë/njësive kundër dhunës në familje dhe trajnimin e gazetarëve në fushën e dhunës në baza gjinore.

Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNKT), gjegjësisht UN-WOMEN si rrjedhojë e punës së madhe gjatë takimeve të shumta konsultative në terren dhe seminareve për zhvillimin e kapaciteteve, ia doli të themelojë Mekanizmat Kordinues për Dhunën në Familje në komunën e Dragashit, dhe riaktivizimin e këtyre mekanizmave në komunën e Gjilanit dhe Gjakovës. Objektiva kryesore e këtij Aktiviteti është përmirësimi i reagueshmërisë së tyre dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për të mbijetuarat nga dhunën në familje.

Në vazhden e shumë aktiviteteve, UN- Women së bashku me PK ka organizuar një ceremoni me rastin e paisjeve të tri dhomave ``miqësore ndaj fëmijëve`` në stacionet policore (Njësitet Kundër Dhunës në Familje) në të tri komunat.

Numri i viktimave të dhunës në familje të strehuara nga strehimoret për periudhën Janar – Dhjetor 2012 është 410, në bazë të raportit të Koalicionit të Strehimoreve të Kosovës, (shih tabelën):

STREHIMORJA	NUMRI I RASTEVE	VIKTIMA TË RRITUR	VIKTIMA FËMIJË
Shtëpia e Sigurt/Gjakovë	71	38	33
Qendra për Mbrojtje dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijeve-``Liria``/Gjilan	89	62	27
Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Femijës-Raba Voca/Mitrovicë	71	35	36
Qendra për Mirëqenien e Gruas/Pejë	67	45	22
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve /Prishtinë	74	28	46
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve/Prizren	38	20	18
TOTALI	410	228	182

Në vazhdim do të paraqesim aktivitete nga Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, respektivisht nga Strehimorja në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë dhe Pejë.

STREHIMORJA - QENDRA PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE (QMGF) - NË PRISHTINË⁶

Ofron shërbime për viktimat e dhunës në familje gra dhe fëmijë me kapacitet strehimi prej 16 shtretërve. Shërbimet që ofrohen brenda strehimores konsistojnë në:

- Shërbime strehimi 24 orësh;
- Sigurim të ushqimit për viktimat e dhunës në familje brenda strehimores;
- Sigurim të mjeteve higjienike personale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të medikamenteve mjekësore për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të këshillimit dhe mbështetjes emocionale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të materialit shpenzues për punë dore për viktimat e dhunës brenda strehimores.
- Sigurim të komunikimit dhe transportit për viktimat

MPMS përkatësisht DMS, në bazë të kontratës dhe marrëveshjes së bashkëpunimit, këtë strehimore e mbështet në shumën prej 50% të shpenzimeve të lartpërmendura për viktimat e dhunës në familje gra dhe fëmijë, deri në Korrik 2012 ka qenë 1250 €, dhe prej Gushtit deri në Dhjetor kjo shumë për një muaj është rritë në 2000 euro.

Pra, nga muaji Janar - Dhjetor 2012 MPMS / DMS ka mbështetur këtë OJQ në shumën prej 18,750.00 euro.

Të dhënat mbi rastet e trajtuara

Kjo Organizatë Joqeveritare-gjegjësisht strehimore për periudhën kohore 01 Janar – 25 Dhjetor 2012 ka strehuar, trajtuar dhe ju ka ofruar shërbime në strehimore - 80 rasteve, viktimat të dhunës, nga të cilat **74 raste gra dhe fëmijë janë viktimat të dhunës në familje.**

Kategorizimi në bazë të llojit të dhunës

- **28** Gra Përfituese/Viktima direkte të **Dhunës në Familje;**
- **25** Fëmijë Përfitues/se Viktima indirekte të **Dhunës në Familje;**
- **21** Fëmijë Përfituese/Viktima direkte të **Dhunës në Familje;**
- **3** Gra Përfituese/Viktimë - Trafikim me Qenie Njerëzore;
- Grua Përfituese - ish Viktimë e Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Dhunim Seksual;
- Mashtrim nga një mike (rasti i Danezes).

⁶Raporti i KSK, faqe 12

Mosha

- **33** Përfituese/Viktima mbi 18 vjec
- **47** Përfituese/Viktima nën 18 vjec

Gjinia

- **56** Përfituese/femra
- **24** Përfitues /meshkuj
(fëmijë 0 – 12 vjeq)

Struktura etnike

- **74** Shqiptarë/e-prej tyre 1 nga Shqipëria
- **2** Ashkalik/e
- **2** Serb/e-fëmijët e viktimit malazeze
- **1** Malazeze
- **1** Daneze

Origjina

- **39** Përfituese/Viktima nga zonat rurale
- **41** Përfituese/Viktimanga zonat urbane

Bujtje , Strehimorja e QMGF në Prishtinë gjatë këtij viti ka ofruar 3112 bujtje për viktima të dhunës, d.m.th, i bie që mesatarisht gjatë vitit një viktimë ka qëndruar 40 netë.

Referimi i rasteve

Kryesisht rastet janë referuar nga partnerët që punojnë në trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si: Qendra për Punë Sociale, Policia e qytetit të Prishtinës, Njësia kundër dhunës në familje, Mbrojtësit e viktimave të regjionit të Prishtinës, OJQ lokale dhe OJQ-strehimoret partnere nga qytetet e tjera.

Shërbimet e ofruara

- Ushqim;
- Veshëmbathje;
- Mjete të higjienës personale
- Medikamente
- Trajtim gjinekologjik

Gjithsej sherbime:

292

- Asistencë dhe Transport rreth shërbimeve mjekësore në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Spital (inçizim të brinjëve, vizitë tek stomatologu, etj);
 - Edukim shëndetësor për mbrojtje nga SST, shëndetin riprodhues, higjienën personale, shprehinë e këqija si duahni dhe droga;
 - Edukim mbi të drejtat e njeriut dhe mbështetja psikosociale
-
- Trajtim psikologjik (individual dhe grupor) gjatë kësaj periudhe në Strehimoren kundër dhunës në QMGF në Prishtinë janë mbajtur gjithsej **84 aktivitete/shërbime**;
 - 41 seanca individuale me përfitueset e moshës madhore;
 - 22 aktivitete psikosociale me 35 fëmijë;
 - 12 seanca grupore me përfitueset e rritura si dhe
 - 9 seanca individuale me fëmijët.
 - Aktivitete ditore si terapi okupuese (gjimnastika e mëngjesit e kombinuar me ushtrime aerobiku, thurje, kurse kompjuteri dhe shërbime interneti, kurse gatimi, lexim, diskutime me tema të vetëdijimit dhe fuqizimit, biseda të lira sipas kërkesës së rasteve;
 - Ndërmjetësim
 - Asistencë rreth kontakteve me institucionet relevante.

Kontaktet

Strehimorja e QMGF në Prishtinë, ka bashkëpunuar ngusht me të gjithë partnerët që janë në procesin e parandalimit mbrojtjes dhe hetimit të dhunës në Familje. Por, në veçanti vërehet një bashkëpunimi shumë i mirë me Qendrat për Punë Sociale, Policinë dhe Mbrojtësit e viktimave gjatë ofrimit të shërbimeve pa dallim, si për ato të dhunës në familje, ashtu edhe për viktimat e formave të tjera të dhunës.

Sfidat e QMGF, në Prishtinë

QMGF në Prishtinë gjatë vitit 2012 është ballafaquar me vështirësi të mëdha financiare, për shkak të mungesë së theksuar të fondeve, në pjesën më të madhe të vitit stafi ka punuar në baza vullnetare, dhe përkundër kërkesave të vazhdueshme që ju ka drejtuar institucioneve të qeverisë, nuk ka gjetur përkrahje. Përkundër, kësaj situatë për asnjë moment nuk është ndërprerë puna e kësaj strehimoreje. Kjo strehimore është në kërkim të donatorëve të mundshëm

Ngritja e kapacitetit të stafit

QMGF në Prishtinë, në vazhdimisi ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve të stafit.

QENDRA PËR MBROJTJEN DHE REHABILITIMIN E GRAVE DHE FËMIJËVE “LIRIA”-GJILAN

Aktivitetet e Qendrës Liria fokusohen në:

Asistencën e përgjithshme dhënë viktimave të të gjitha formave të dhunës;

- **Strehim, Akomodim dhe Rehabilitim**
- **Këshillillimi**
- **Institucionalizim**
- **Ngritje të vetëdijes në zonat rurale**
- **Ngritje të kapacitetit të stafit**

Kushtet dhe kapacitetet e strehimit

Strehimorja e QMRGF Liria në Gjilan ka kapacitet **15 shtreter + 3 shtreter rezerve** për situatat të jashtëzakonshme dhe kanë **1 shtrat për foshnje**

Liria strehon viktimat të dhunës në familje dhe viktimat të prekura nga çfarëdo forme e dhunës, atyre u ofrohet siguri fizike, ushqim, medikamente, mirëmbajtje të higjienës, veshmbathje, **periudhë reflektimi (48 ore)**, qetësi, akomodim dhe adoptim me ambientin e ri banues , adoptim me orarin dhe rregullat e strehimores, mundësi kontakti me institucionet mbështetëse, komunikim me familjaret, prezantim të pakove të shërbimeve ku do të përfshihen, vlerësim të nevojave emergjente të tyre si dhe hartim të planit individual të kujdesit për secilën përfituese. Në momentin e pranimit, përfitueset u ofrohet pakoja e përkujdesje dhe mirëqenies personale, si dhe pakoja higjienike për secilën të strehuar. Secila përfituese evidentohet me të gjitha të dhënat personale ku secila ka dosje personale të dokumenteve ku grumbullohen të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me rastin.

Gjatë kësaj periudhe raportuese 1 vjeqare, 1 Janar - Dhjetor 2012 në Strehimoren “Liria” kanë gjetur strehim:

- Gjithsejtë 89 raste: 62 gra dhe 27 fëmijë.
- Prej tyre 30 gra me 18 fëmijë kanë qenë raste që janë bartur nga muajt paraprak.
- Ndërsa 32 gra me 9 fëmijë kanë qenë raste të reja.

Për të dhënë një raport statistikor mbi dhunën që ushtrohet ndaj grave dhe fëmijëve si dhe për të kuptuar grupmoshën, statusin social, ekonomik, arsimor dhe kulturor të tyre po japim të dhënat e mëposhtme.

<u>Struktura Gjinore</u> • 35 Femra • 6 ëmijë meshkuj	<u>Struktura moshore</u> • 9 fëmijë (0- 12 vjeq) • 7 femra adoleshente (13-18 vjeq) • 25 femra te rritura (19-55vjeq)
<u>Struktura etnike</u> • 33 Shqiptare • 2 Serbe • 3 Rome • 2 Moldave • 1 Ashkalike <u>Niveli i arsimimit:</u> • 3 Analfabete • 17 Shkollim fillor • 12 Shkollim të mesëm	<u>Zonat e banimit;</u> • 13 raste nga zonat urbane • 19 raste nga zonat rurale <u>Lloji i dhunes:</u> • 35 viktima të dhunës në familje • 2 viktima të keqtrajtimit seksual • 4 viktima të trafikimit <u>Gjendja Ekonomike</u> • 11 Te hyra nga paga mujore • 21 Te hyra nga asistenca sociale

Sipas nevojës së viktimave “Liria” ka ofruar këto shërbime dhe trajtime mjekësore:
Vizita dhe kontrolle

- Mjekësia Familjare, Emergjencia (46 matje tensioni, **28** infuzion, **64** injeksione, 36 analiza laboratorike, 4 stomatologjike)
- Reparti i Gjinekologjisë (5 Papë-test, 42 Ultrazë, **1** Abort)
- Reparti i Pediatriisë (**1** Hospitalizim, **14** kontrolla te specialisti)
- Reparti i Psikiatriisë (**14** kontrolla te psikiatri)
- Reparti Kirurgjisë (4 lidhje dhe pastrim i plagëve të marra si pasojë e dhunës)
- Rëntgen 7 .

Liria në bashkëpunim me institucionet relevante QPS, PK dhe MV ka ndërmjetësuar që të gjitha rastet të integrohen në familje dhe shoqëri.

Qendra Liria ka ofruar edhe këshilla juridike dhe sociale për gratë që nuk janë të strehuara por që i drejtohen qendrës për ndihmë.

- **51** Këshilla juridike
- **117** Sociale
- **155** Psikologjike

1.STREHIMORJA - SHTËPIA E SIGURT (SHES) - NË GJAKOVË

Ofron shërbime për viktimat e dhunës në familje gra dhe fëmijë, me kapacitet strehimi prej 14 shtretërve. Shërbimet që ofrohen brenda strehimores konsistojnë në:

- Shërbime strehimi 24 orësh;
- Sigurim të ushqimit për viktimat e dhunës në familje brenda strehimores;
- Sigurim të mjeteve higjienike personale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të medikamenteve mjekësore për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të këshillimit dhe mbështetjes emocionale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të materialit shpenzues për punë dore për viktimat e dhunës brenda strehimores.
- Sigurim të komunikimit dhe transportit për viktimat

Kjo strehimore për periudhën kohore për të cilën po raportojmë ka strehuar, trajtuar dhe ju ka ofruar shërbime **71** rasteve, prej tyre

Mosha

- **38** viktima të rritura
- **33** fëmijë

Struktura etnike

- **56** Shqiptarë
- **8** Ashkali
- **7** Egjiptas

Origjina

- **33** Urbane
- **38** Rurale

Shërbimet e ofruara

Mbështetja psikosociale: për viktimat e dhunës është bërë përmes këtyre aktiviteteve,

- **252** Seanca individuale
- **6** Seanca grupe

Temat: kërkim falja, emertimi i ndjenjave, emocionet, vendi i sigurt komunikimi i drejtë

- **2** Ushtrime meditimi
- **2** Ndërmjetësim
- **41** SOS thirrje
- **16** Ballë për ballë

Kursi i kompjuterit:

- **38** kanë vazhduar kursin, prej tyre
- **17** kanë arritur njohuritë bazë
- **21** Janë avansuar në kompjuter
 - 29** të rritura
 - 9** fëmijë

Kursi i anglishtes:

- **27** veta kanë vazhduar kursin e anglishten
 - **17** gra
 - **10** fëmijë
- **13** gra janë avancuar në kursin e anglishtes
- **8** fëmijë kanë marrë njohuritë bazë.

Kursi i punës së dorës:

- 16** gra në qendrisje me ngjyra
- 13** qendrisje me rruaza
- 10** veta në rrobaqepësi
- 7** veta në qendrisjen me arë
- 6** kanë vazhduar kursin për parukeri
- 6** janë punësuar në organizata të ndryshme në periodën prej një viti kremëra nga produktet e mjaltës
- 16** gra janë aftësura për përgatitjen e kremave.

Nga shërbimet e marra dhe intevenimet në infrastrukturë

- Është bërë riparimi i dëmëve nga bora e madhe.
- Është arritur shkallë më e lartë e komunikimit brenda vet klienteve
- Është ngritur niveli i arsimimit të vet klienteve
- Është arritur rezultat në shkollë nga fëmijët e strehuar
- Janë punësuar gjatë kësaj periudhe me pagë ditore **10 kliente**
- Kanë punuar në kultivimin e luleve në seren e Shtëpisë së sigurt **4 kliente.**
- Është punësuar në punë të rregullt **1 kliente**
- Të gjitha këto kanë ndihmuar jo vetëm rehabilitim shpirtëror të klienteve por edhe reintegrimin e tyre në shoqëri ato ndihen më të qeta, sigurta , me të lumtura .
- **Kanë vazhduar të ndihmohen nga fondi social duke u reintegruar plotësisht me pagesën e rrymës dhe të qerasë 7 nëna me 16 fëmijë**

Puna me fëmijët

Pedagogia ka punuar me të gjithë fëmijët e strehuar në SheS të cilët kanë qenë nga moshë 0-15vjeq.

- 15** nëna janë ndihmuar në kujdesin ndaj fëmijëve,
- 11** fëmijë kanë vazhduar mësimin në shkollë (janë siguruar lejekalimet prej shkollave paraprahe, atyre u është ndihmuar në detyra të shtëpisë organizimin e lojërave logjike, Janë mbajte takime të rregullta me drejtorin , zv.drejtoreshen e shkollës „Fehmi Agani”, Kanë marrë pjesë në seancat me psikologun duke organizuar drama , recitime, vallëzim)
- 3** vajza është regjistruar ne çerdhen,, Ganimete Terbeshi,, në Gjakovë
- 1** vajzë ka vazhduar mësimin në shkollën speciale .

Ngritja profesionale e viktimave

- 20 raste (gra dhe fëmijë) - kursi i kompjuterit
- 17 raste (11 gra, 6 fëmijë) - kursi i anglishtes
- 28 raste gra - kurse e pune dore (qëndisje me ar , rrobaqepësi, thurjeme krabëza dhe me grep)
- 12 gra - Prodhimi i kremrave
- 8 gra - Puna me bletët
- 5 gra - Puna në serë
- Pjesëmarrje ne dy panaire me produktet e bletës dhe qëndisjes me ar
- 15 gra - Angazhimi ne fitness
- 5 nënave me 5 fëmijë - Ri-integrimi

Këshillim juridik

- E drejta e pronës
- Roli i gruas në familje
- Spjegimi i ligjit per tu mbrojtur nga dhuna në familje
- E drejta e trashëgimisë
- Dhuna shtepiake – Mitet dhe faktet mbi dhunen”
- Të drejtat dhe obligimet nga lidhja e martesës
- Raportet familjare - rregullimi i tyre

STREHIMORJA - QENDRA PËR MBROJTJEN E GRUAS DHE FËMIJËS - RABA VOCA - NË MITROVICË

Ofron shërbime për viktimat e dhunës në familje gra dhe fëmijë me kapacitet strehimi prej

14 shtretërve. Shërbimet që ofrohen brenda strehimores konsistojnë në:

- Shërbime strehimi 24 orësh;
- Sigurim të ushqimit për viktimat e dhunës në familje brenda strehimores;
- Sigurim të mjeteve higjienike personale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të medikamenteve mjekësore për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të këshillimit dhe mbështetjes emocionale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të materialit shpenzues për punë dore për viktimat e dhunës brenda strehimores.
- Sigurim te komunikimit dhe transportit për viktimat

Të dhënat mbi rastet e trajtuara

Kjo strehimore për periudhën kohore gjashtëmujori i pare 2012 ka strehuar, trajtuar me shërbime strehimore **71 raste**.

Mosha

- **35** raste te rritura
- **36** fëmijë

Struktura etnike

- **69** shqiptarë
- **1** rom
- **1** ashkali

Gjinia

- femra 54 raste
- meshkuj 17 raste

Origjina

- 27 raste z. urbane
- 44 raste z. Rurale

Bujtje

- Totali i buajtjeve për këtë periudhë kohore gjithësej 71 përfitues/e me **1427 buajtje**.

Edhe gjatë kësaj kohe Strehimorja QMGF – Raba Voca, në Mitrovicë ka ofruar shërbime sociale dhe familjare sipas nevojave të viktimave të strehuara. Shërbimet janë ofruar komfrom vlerësimit të nevojave që kanë pasur viktimat. Shërbimet e ofruara nga kjo strehimore janë;

- Këshilla mjeksore
- Edukim shëndetsor
- Seanca psikologjike
- Mbeshtetje Psiko-sociale
- Aktivitete të Terapisë Okupuese
- Kurse të Kompjuterve
- Kurse të Rrobaqepësisë
- Kurse të Kuzhinës
- Kurse të Flokëtarisë
-

Reintegrimi në familje / bashkimi familjar

- **55** përfitues kanë shkuar në familjet e mëparshme
- **6** përfitues kanë shkuar te prindërit
- **4** përfitues ende gjenden në strehimore
- **2** fëmijë janë ndarë nga nëna dhe nën përcjelljen e QPS-Vushtrri referuar janë te babai
- **1** përfitues ka nënshkruar deklaratë dhe ka dalë me vetëdëshirë (ka shkuar te një shoqja)
- **1** përfitues në strehimoren e Pejë
- **1** përfituese është referuar në QKUK Klinikën Psikiatrike në Prishtinë
- **1** përfituese është referuar te i dashuri

STREHIMORJA - QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS – SHTËPIA E SIGURTË NË PEJË

Ofron shërbime për viktimat e dhunës në familje gra dhe fëmijë me kapacitet strehimi prej 18 shtretërve. Shërbimet që ofrohen brenda strehimores konsistojnë në:

- Shërbime strehimi 24 orësh;
- Sigurim të ushqimit për viktimat e dhunës në familje brenda strehimores;
- Sigurim të mjeteve higjienike personale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të medikamenteve mjekësore për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të këshillimit dhe mbështetjes emocionale për viktimat e dhunës brenda strehimores;
- Sigurim të materialit shpenzues për punë dore për viktimat e dhunës brenda strehimores.
- Sigurim të komunikimit dhe transportit për viktimat

Të dhënat mbi rastet e trajtuara

Kjo strehimore për periudhën kohore për të cilën po raportojmë ka strehuar, trajtuar dhe ju ka ofruar shërbime 67 rasteve, viktimat të dhunës në familje.

Mosha

45 gra
22 fëmijë

Origjina

14 raste - Urbane
35 raste - Rurale

Reintegrimit

Janë përgatitur **41 raste gra** bashkë me **22 fëmijë** të tyre për reintegrim

Shërbimet e Ofruara

Kryesisht viktimat e dhunës të strehuara në këtë strehimore kanë përfitua nga shërbimet ;

- Këshillim psikosocial i cili është i kombinuar duke përfshi teknikat –
- Muziko-terapia (ritmike,relaksuese dhe meditimi)
- Këshillim juridik
- Edukim
- Shëndet

Struktura etnike

41 Shqiptar
2 RAE
2 Boshnjak;

Tryezat e rrumbullakëta

Gjatë këtij viti Liria ka zhvilluar tryeza të rrumbullakta me zyrtare të institucioneve të Gjilanit, Ferizajit, Novobërdës, Kaçanikut, Kamenicës (Dardanës) dhe Vitisë. Tema e këtyre takimeve ka qenë Dhuna në Familje dhe sfidat e trafikimit me qenje njerëzore si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional.

Janë realizuar 45 punëtori me gra në 22 fshatra të Komunës së Gjilanit, Vitisë, Kamenicës (Dardanës), Novobërdës, (me një mesatare prej 16-28 gra pjesëmarrëse në secilën punëtori).

3. Përmbledhja e aktiviteteve

Përmbledhja e aktiviteteve të zbatuara sipas Planit të Veprimit në kuadër të shtyllës së mbrojtjes është si në vijim:

Grupi punues nga ABGJ-ja, MPB, MD, PK, Mbrojtësit e Viktimave dhe Përfaqësuesi i Strehimoreve, i mbështetur nga Ambasada Amerikane dhe nga UNDP/WSSI, kanë realizuar disa takime me qëllim të draftimit të Procedurave Standarde Operative të Veprimit, që duhet të miratohen nga Grupi Koordinues Ndër-Ministror në fillim të vitit 2013.

Policia e Kosovës vazhdon të jetë përgjegjëse për: secilin raportim të veprës me karakter të dhunës në familje; shkëlqes së urdhërit për mbrojtje apo mbrojtje emergjent, ajo ka autorizimin për përdorimin e mjeteve të arsyeshme me qëllim të mbrojtjes apo parandalimit të dhunës ndaj viktimave. Ajo ka organizim të mbrendshëm shumë funksional duke filluar nga Njësiti Qëndror Kundër Dhunës në Familje e deri te njësitet që mirren me këtë dukuri, duke marrë përgjegjësit që dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Nëse bëhet një krahasim i raporteve policore 2011-2012 do të kuptohet se efikasiteti policor është në ngritje sa i përket ndjekjes ndaj kryesëve të kësaj vepe.

Në Vitin 2011 kishte 1046 raste të raportuara, ndërsa 824 kallëzime penale të ushtruara, ndërsa në 2012 me 1021 raste të raportuara në polici, ishin ushtruar 902 kallëzime. Pra vërehet një rënie të lehtë të raportimit të rasteve dhe një ngritje të ndjekjes penale.

Prokurori i Shtetit, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) ka ofruar shërbime 24 orë, duke punuar në 868 raste të dhunës në familje në tërë territorin e Kosovës, duke i ndihmuar viktimat gjatë procesit në polici, prokurori, gjykata, ofrimin e ndihmës mjekësore, informim e këshillim, përfaqësim dhe strehim.

Nga 45 thirrjeve të pranuar nga operatorët e linjës ndihmëse, të rasteve të dhunës në familje, 12 prej tyre iu janë referuar PK për procedurë të mëtutjeshme, ndërsa të tjerat janë informuar dhe këshilluar për rastet e tyre.

Mbrojtësit e Viktimave kanë inicuar 460 urdhëra mbrojtës, prej tyre 68 urdhëra mbrojtës emergjent, ata gjithashtu kanë strehuar 126 raste të dhunës në familje, ndërsa gjykatat kanë lëshuar 292 urdhëra për mbrojtje në nivel të Kosovës.

Prokuroritë lidhur me kallëzimet penale të ushtruara, kanë vendosur për 581 raste dhe duke mbetur të pazgjidhura 135 raste, ku 120 raste ishin të trashëguara nga viti i kaluar.

Ndërsa gjatë 2012, Prokuroritë kompetente për veprat penale Dhuna në Familje, për kryesit e mitur kanë pranuar gjithsej 11 raste, me 14 persona. Kurse gjithsej në punë kanë pasur 26 persona. Gjate vitit paraprak kanë trashëguar 3 raste me 12 persona. Raportohet se kanë mbetur të pazgjidhura 17 raste me 17 persona.

Lidhur me kallëzimet penale kanë vendosur për 9 raste: kundër 7 personave kanë hedhë kallëzimin penal; kundër 2 personave është propozuar shqiptimi i masës edukative.

Koalicioni i Strehimorëve të Kosovës (KSK) është i angazhuar dhe përgjegjës në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për viktimat e dhunës në familje. Nga 8-OJQ anëtare, 6 prej tyre janë strehimore të cilat ofrojnë strehim dhe shërbim për viktimat.

Strehimoret janë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët që mirren me trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si: Qendrat për Punë Sociale, PK - Njësitë Kundër Dhunës në Familje, Mbrojtësit e Viktimave dhe OJQ-të lokale.

Përkrahja, Trajtimi dhe Re-integrimi

1. Progresi i përgjithshëm në shtyllën e rehabilitimit

Është shtylla e tretë e Programit, në kuadër të së cilës do të identifikohen dhe ofrohen forma veprimi me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje, trajtimin profesional të kryesëve dhe abuzuesëve të dhunës në familje deri në integrimin e plotë të tyre në jetën normale.

Re-integrimi i viktimave të dhunës në familje është një proces i gjatë që kërkon një qasje serioze, të disiplinuar dhe njëkohësisht një kyçje të gjithë akterëve që punojnë në mbrojtjen dhe ofrimin shërbimeve për viktimat e dhunës deri në një fuqizim të plotë të viktimës.

Kjo shtyllë ka bërë progres në krahasim me kohën e kaluar, por mbetet shumë punë e përpjekje në vitet e ardhshëm me qëllim të përmbushjes së qëllimit strategjik.

2. Aktivitetet kryesore

MPMS, pos përgjegjesive tjera, harton standardet minimale për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për viktimat e dhunës në familje, monitoron dhe inspekton kualitetet e shërbimeve sociale dhe siguron zbatimin e politikave, legjislacionit dhe minimumin e standardeve për ofrimin e shërbimeve.

Përveç shërbimeve sociale që ofrohen nga QPS në tërë teritorin e Kosovës, MPMS ka krijuar një partneritet të mirë me OJQ të cilat kanë në programet e tyre trajtimin, strehimin dhe përkrahjen e viktimave të dhunës në familje.

MPMS në bazë të kontratës dhe marrveshjes së bashkëpunimit, OJQ-strehimoret i mbështet në shumën prej 50% të shpenzimeve për viktimat e dhunës në familje, gra dhe fëmijë, ku kjo shumë për një muaj është 2000€ (24000€ në vit për secilën strehimore).

Ndërsa QPS-të nga janar - dhjetor 2012 kanë raportuar për: 300 raste ,nga të cilat 220 viktima të rritura (gra), 15 raste viktima të drejtëpërdrejta të mitura, dhe 65 fëmije indirekt të prekur nga dhuna në familje e që janë trajtuar së bashku me viktimat e dhunës në familje.

Qendrat për Punë Sociale rastet e dhunës në familje i kanë trajtuar në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë partneret, si: familja, OJQ-strehimore, Mbrojtësit e Viktimave, Policinë e Kosovës, shkollat, gjykatat, institucionet etj.

WSSI ka mbështetur financiarisht Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijeve (strehimorja në Prishtinë) gjatë 2011 e deri në Prill 2012 me gjithsej 30.000€. Ndërsa disa aktivitete të lidhura me këtë objektiv nuk janë realizuar, për shkak të vonesave nga KSK e që lidheshin me lobimin për krijimin e një linje buxhetore për financim afatgjatë të strehimoreve nga buxheti i Kosovës.

OSBE në kuadër të projektit ``Rritja e Përgjegjësisë ndaj barazisë gjinore dhe çështjes të dhunës në familje`` ka zhvilluar aktivitete të ndryshme në trajnimin e punëtorëve social dhe përfaqësuesëve të strehimoreve/OJQ-ve, trajnimin e Mbrojtësve të Viktimave, trajnimin e PK përkatësisht Njësive kundër Dhunës në Familje dhe trajnimin e gazetarëve në fushën e dhunës në baza gjinore.

Ministria e Shëndetësis (Njësi për të Drejtatat e Njeriut) në bazë të 7-vizitave të Drejtorive Shëndetësore Komunale, Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Graçanicë dhe Gjiilan, nga ka rezultuar se institucionet shëndetësore të kujdesit primar janë të gatshme t'iu ofrojnë shërbime shëndetësore viktimave dhe janë në bashkëpunim të ngushtë me PK, me QPS dhe strehimoret.

Në kuadër të kësaj shtylle UNDP ka bërë identifikimin e mundësive ekonomike për të mbijetuarit nga dhuna në familje në të tri pilot-komunat. Në partneritet me strehimoret dhe zyret regjionale për punësim janë trajnuar/punësuar për 12 muaj, gjithsej 23 viktima. Ky aktivitet ka ngritur pavarësinë ekonomike të përfituesëve në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe ka ndikuar indirekt në ndihmën e fëmijëve dhe komunitetit.

3. Përmbledhja e aktiviteteve

Programi nacionale kundër dhunës në familje synon rritjen e qasjes në shërbime për viktimat e dhunës në familje, me qëllim të parandalimit të dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimin e rehabilitimin e dhunuesve.

Në vazhdim do të paraqesim një përmbledhje të shkurtë të të gjitha strehimoreve të Kosovës dhe shërbimeve të përgjithshme që ofrojnë me rastet e dhunës në familje. Strehimoret e Kosovës të cilat ju ofrojnë strehim dhe shërbime viktimave të dhunës në familje:

- ❖ *SHTËPIA E SIGURTË - Strehimorja në Gjakovë*
- ❖ *QENDRA PËR MBROJTJEN DHE REHABILITIMIN GRAVE DHE FËMIJË, Strehimorja në Gjilan*
- ❖ *QENDRA PËR MBROJTJEN E GRUAS DHE FËMIJËS - RABA VOCA, Strehimorja në Mitrovicë;*
- ❖ *QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS, Strehimorja në Pejë;*
- ❖ *QENDRA PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE, Strehimorja në Prishtinë;*
- ❖ *QENDRA PËR STREHIMIN E GRAVE DHE FËMIJËVE, Strehimorja në Prizren;*

Përveç strehimit dhe sigurisë së lartë strehimoret ofrojnë edhe një mori shërbimesh për viktimat e dhunës në familje:

- Sigurimi i ushqimit;
- Sigurimi mjeteve higjienike personale;
- Sigurim të medikamenteve mjekësore;
- Sigurim të këshillimit dhe mbështetjes emocionale;
- Sigurim të materialit shpenzues për punë dore,
- Sigurim të transportit dhe komunikimit,

- Sigurim të aktiviteteve rehabilituese dhe relaksuese,
- Sigurim të aktiviteve dhe trajnimeve profesionale për reintegrim të viktimave,
- Sigurim të aktiviteve për trajnime dhe ngritje profesionale të vazhdueshme për personelin e strehimoreve,
- Aktivitete lobuese dhe avokuese në të gjitha sektorët e shoqërisë për fuqizimin e strehimoreve dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve nëpër strehimore,

Shërbime shëndetësore (intervenime gjinikologjike, injeksione, analiza laboratorike, psikiatri etj); **mbështetja psiko-sociale e viktimave** (bëhet përmes seancave individuale dhe grupore); **ngritja profesionale e viktimave** (kurse për kompjuter, kurse të gjuhës angleze; kurse të punës së dorës prodhime të kremave, puna me bletë, ri-integrimi në familje/bashkim familjar etj); **këshillime juridike** etj.

VI. Bashkëpunimi dhe Sinergjia

Dhuna në familje nuk është risi në vendin tonë, ajo si e tillë është luftuar nga mekanizmat shoqëror edhe me herët, por ka munguar koordinimi, bashkërendimi, monitorimi dhe raportimi i politikave, aktivitetet dhe veprimet tjera të domosdoshme, e të cilat tani i kemi në Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014.

Programi si i tillë është sfidë dhe kërkohet domosdoshmërisht mbështetja e të gjitha ministrive, agjensioneve, shoqërisë civile, medias dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Koordinatori Nacional ka mbjatur disa takime me Grupin Koordinues Ndër-Ministror dhe anëtarët tjerë të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, komunikimi profesional ka reflektuar sinergji në mes të akterëve.

Megjithatë mbeten punë për tu bërë, duke e patur parasysh përmbledhjen e analizes SWOT-të bërë nga Grupi Punues i Programit, ku rezultojn se:

Janë përparësi: Bashkëpunimi ndërinstitucional për trajtimin e kategorive të dhunës në familje (gra dhe fëmijë), bashkëpunimi i institucioneve qeveritare me organizatat jo-qeveritare profesionale në fushën e luftës kundër dhunës në familje.

Sfidat

Sfidat kryesore, të përpjekjeve në luftën kundër dhunës në familje në Kosovë janë:

- Implimentimi i ligjeve ekzistuese në fushën e mbrojtjes dhe parandalimit,
- Gjendja socio-ekonomike në Kosovë, më saktësisht shkalla e lartë e varfërisë dhe varfërisë së skajshme, si dhe shkalla e lartë e papunësisë,
- Përballja e institucioneve me sfida operative, mungesa e mjeteve dhe pajisjeve për policinë dhe prokurorët për kryerjen e punëve të tyre operacionale të hetimeve dhe për gjykatat,
- Mungesa e një baze të të dhënave të integruara në nivel nacional për kategorin e viktimave,
- Koordinimi i pa mjaftueshëm ndërmjet institucioneve vepruese,
- Pamjaftueshmëria dhe cilësia e dobët e shërbimeve ekzistuese, e strehimoreve, e trajnimeve profesionale, e programeve të integritit të përhershëm të viktimave dhe mungesa e banesave sociale për rastet e viktimave,
- Mentaliteti dhe e drejta zakonore,
- Ngritja e kapaciteteve dhe etikës profesionale.

Kunkluzionet

Sfidat dhe vështirësit janë evidente në punët e përditshme në parandalimin, mbrojtjen, trajtimin, rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës në familje, por mund të konstatojmë se programi ka avancuar.

Grupi Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje është mbledhur disa herë gjatë vitit, bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve ka qenë në nivel, raportimi me kohë dhe korrekt i të gjithë anëtarëve Zyrës së Kordinatorit Nacional për aktivitetet e tyre për 2012 dëshmon një gjë të tillë.

Nga grupi punues (ABGJ,MPB, PK, MD, MV,Strehimoret dhe një ekspert nga WSSI) i mbështetur nga Ambasada Amerikane ka hartuar Procedurat Standarde Operative të Veprimit.

Këtë vit i është kushtuar mjaft kujdes çështjes të ngritjes së vetëdijes së qytetarët për pasojat e dhunës në familje, përmes reklamave e emisioneve të ndryshme televizive, tryezave të rrumbullakëta dhe mediave të shkruara.

Me rastin e 16 ditëve të aktivizmit - ditës ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas u organizuan shumë aktivitete nga të gjithë akteret.

Përpyjekjet kanë qenë të orientuara në rritjen e ndërgjegjëjes së publikut në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saja për shoqërinë në përgjithësi.

Duhet të potencohet se më 11 Korrik 2012 u emërua Kordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje, ndërsa takimi i parë me qëllim të konstituimit të grupit ndër-ministror u mbajt me 17 Shtator, kështu që duke pasur parasysh afatin e shkurtër kohor mund të themi se megjithatë janë ndërmarrë aktivitete shumë të rëndësishme nga akterët e programit.

Rekomandimet dhe hapat e mëtejme

Komunikata e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, të kriteret politike, në shtyllën e të drejtave të njeriut (drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale) konstaton se Korniza ligjore e Kosovës siguron të drejtat e grave.

Barazia gjinore është gjithashtu e garantuar në sistemin ligjor, por zbatimi është i ngadalshëm. Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje duhet të përmirësohet. Legjislacioni për anti-diskriminimin është i përshtatshëm edhe pse zbatimi i tij praktik mbetet një sfidë. Është i nevojshëm vullneti më i madh politik për të promovuar tolerancën.

Sipas MSA-së, Kosova do të duhet të respektoj dhe zbatoj parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, sikurse përcaktohet në dokumentet kryesore ndërkombëtare siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndërsa, bazuar në monitorimin e aktiviteteve (në atë që është bërë deri më tani dhe çfarë duhet të bëhet) të akterëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu edhe **raportin e monitorimit** të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014, nga ana e WSSI Plus e UNDP-së (i financuar nga MPB e Holandës), dalin këto rekomandime:

Ligji Kundër Dhunës në Familje, është i vlerësuar, por kërkohet zbatimi i tij në praktikë, megjithatë bëhet vërejtje në lëshimin e urdhërit për mbrojtje emergjente, në ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe asistencës sociale pa pagesë, kërkohet të rritet shuma e dënimeve për shkeljen e urdhërit mbrojtës me gjobë për 100%.

Andaj:

- *Duhet të punohet më shumë me njësitet/departamentet komunale me qëllim të promovimit të programit, meqë ato nuk janë sa duhet në dijeni për këtë strategji të miratuar nga qeveria dhe për faktin se është në zbatim e sipër;*
- *Të sigurohet një financim më stabil për strehimoret, meqë gjendja e tyre për momentin është e vështirë sidomos në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan dhe Prizren.*
- *Të përcjelllet në përpikmëri nga media, zbatimi i Programit duke publikuar çdo debat, tryeza e aktivitete në lidhje me dhunën në familje;*
- *Të vazhdoj kontributi i shoqërisë civile në organizimin e fushatave për vetëdijesimin e popullatës për raportimin e dhunës në familje dhe informimi për strukturën ligjore;*
- *Të krijohet një sistem i të dhënave statistikore periodike të unifikuara mbi dhunën në familje;*
- *Të vazhdoj organizimi i fushatave me qëllim të ngritjes së vetëdijes për dukurin e dhunës në familje;*
- *Më shumë sesione informative për komunitetin me qëllim të parandalimit të dhunës në familje (ku të raportohet, ku të kërkohet ndihmë etj), me theks të veçantë në zonat me të prekura;*
- *Komunikimi dhe koordinimi më i mirë në mesin e akterëve - pjesëmarrës në fushatën;*
- *Linja duhet të promovohet më shumë nëpërmjet botimeve të ndryshme që lidhen me dhunën në familje;*
- *Organizimi i sesioneve të trajnimit (për dhunën në familje) në nivel lokal, drejtoritë komunale për punë dhe mirëqenies sociale, drejtoritë komunale për arsim dhe qendrat e mjekësisë familjare (më shumë buxhet nga komunat);*
- *Më shumë pajisje në logjistikë për prokurorinë, gjykatat dhe policinë, në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti i hetimeve dhe procedurave gjyqësore;*
- *Përgatitja dhe mbështetjen e programeve më të mira për reintegrimin afatgjatë dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje;*

X. Shtojcat

A. Statistika e Policisë së Kosovës lidhur me viktimat e dhunës në familje

Gjithsejtë numri i rasteve të Dhunës në Familje	Viti 2012
Numri i rasteve të dhunës në familje	1021
Viktima të strehuara	302
Viktima të identifikuar - femra	822
Viktima të identifikuar – meshkuj	219
Arreste	260
Kallëzime penale	902

B. Institucionet që kanë raportuar

Ky raport është hartuar në bazë të informacioneve të marrura në formë raporti nga palët e mëposhtme:

Institucionet Vendore	
Ministria e Punëve të Brendshme	☒
Ministria e Drejtësisë	☒
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	☒
Ministria e Shëndetësisë	☒
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	☒
Ministria e Financave	☒
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	☒
Policia e Kosovës / Divizioni Kundër Dhunës në Familje	☒
Agjencia e Statistikave të Kosovës	☒
Prokurori i Shtetit / Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	☒
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	☒
Instituti Gjyqësor i Kosovës	☒
Agjencia për Barazi Gjinore	☒

OJQ-të Vendore / Institucionet dhe OJQ-të Ndërkombëtare	
Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës	☒
Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës	☒
UNDP / WSSI Plus	☒
OSBE / Sektori për Barazi, jo-Diskriminim dhe kundër-Trafikim me Qenie Njerzore	☒
UNKT –Programi i Përbashket i UNKT-së Kundër Dhunës në Familje në Kosovë	☒